



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



# KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

*Raporti vjetor i punës për vitin 2016*

*drejtuar*

*Kuvendit të Republikës së Kosovës*

*Mars 2017*

## PËRMBAJTJA

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>6</b>
<b>KORNIZA LIGJORE .....</b>	<b>7</b>
<b>PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT .....</b>	<b>7</b>
<i>Misioni i KPM-së është:.....</i>	<i>7</i>
<b>ORGANIZIMI INSTITUCIONAL .....</b>	<b>7</b>
<i>Përbërja dhe mandati i anëtarëve të KPM-së .....</i>	<i>7</i>
<i>Nominimet e anëtarëve të KPM-së .....</i>	<i>8</i>
<i>Përbërja e KPM-së gjatë vitit 2016.....</i>	<i>8</i>
<b>AKTIVITETET E KPM-së.....</b>	<b>9</b>
<i>Vendimet e KPM-së në vitin 2016: .....</i>	<i>13</i>
<b>PUNA NË HARTIMIN DHE AMANDAMENTIMIN E AKTEVE NËNLIGJORE.....</b>	<b>13</b>
<i>Konsultimet publike lidhur me aktet nënligjore të KPM-së .....</i>	<i>13</i>
<b>RIPËRTËRITJA E LICENCAVE PËR RADIO STACIONET TË CILAVE U SKADON LICENCA GJATË VITIT 2016 .....</b>	<b>14</b>
<b>LICENCIMI PËR TRANSMETIMIN E PROGRAMEVE NË RADIO, NË TRI (3) KOMUNA TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS .....</b>	<b>15</b>
<b>BASHKËPUNIMI ME AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIO-VIZIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.....</b>	<b>16</b>
<b>BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA VENDORE.....</b>	<b>16</b>
<i>Bashkëpunimi me Autoritetin Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP).....</i>	<i>16</i>
<i>Bashkëpunimi me Zyrën për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta në kuadër të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve (MKRS).....</i>	<i>16</i>
<b>BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE .....</b>	<b>17</b>
<i>Bashkëpunimi me Zyrën e UNICEF-it në Kosovë .....</i>	<i>17</i>
<b>BASHKËPUNIMI ME FONDACIONIN THOMPSON.....</b>	<b>17</b>

<b>PJESËMARRJA E KPM-SË NË KONFERENCËN E EPRA-SË (PLATFORMA EVROPIANE E AUTORITETEVE RREGULLATIVE) 25-27 MAJ 2016 BARCELONË /SPANJË</b> .....	<b>18</b>
<b>RAPORTIMI I KPM-së NË TAKIMIN E DIALOGUT TË PROCESIT TË STABILIZIM ASOCIIMIT</b> .....	<b>18</b>
<b>PUNA E ZYRËS EKZEKUTIVE</b> .....	<b>19</b>
<i>Burimet njerëzore</i> .....	<b>19</b>
<b>DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZAVE (DMA)</b> .....	<b>20</b>
<i>Monitorimi i zgjedhjeve lokale për kryetar të Komunës së Drenasit</i> .....	<b>20</b>
<i>Pajtueshmëria me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së - Pjesa 3 e Licencës</i> .....	<b>20</b>
<i>Të gjeturat nga Monitorimi</i> .....	<b>21</b>
<i>Pajtueshmëria me Rregulloren KPM 2013/02 për të Drejtën e Autorit</i> .....	<b>21</b>
<i>Pajtueshmëria me Rregulloren KPM 2013/03 për Komunikimet Komeriale Audio-Vizuele</i> .....	<b>21</b>
<i>Pajtueshmëria me Rregulloren KPM 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale</i> .....	<b>22</b>
<i>Pajtueshmëria me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës</i> .....	<b>22</b>
<i>Pajtueshmëria me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për Distribuimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë</i> .....	<b>22</b>
<i>Vizitat/ Inspektimet</i> .....	<b>23</b>
<b>DEPARTAMENTI I LICENCIMIT</b> .....	<b>23</b>
<i>Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës</i> .....	<b>23</b>
<i>Numri i TV dhe Radio stacioneve sipas gjuhëve:</i> .....	<b>24</b>
<i>Numri Operatorëve të Shpërndarjes (OSH) të licencuar:</i> .....	<b>24</b>
<i>Ofruesit e Shërbimeve Mediale Adio dhe adiovizuale (OSHMA) të cilët transmetojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes</i> .....	<b>24</b>
<i>Shqyrtimi i kërkesave</i> .....	<b>25</b>
<i>Rastet të cilat janë mbyllur pa pasur nevojë për vendim të Komisionit, gjithsej janë 9:25</i>	

<i>Rastet që janë bartur për shqyrtim në vitin 2017, janë gjithsej 8 raste: .....</i>	<i>25</i>
<i>Licencimi i radio stacioneve të reja .....</i>	<i>26</i>
<b>DEPARTAMENTI LIGJOR .....</b>	<b>26</b>
<i>Rastet për transmetim ilegal - Shkelja e nenit 21, paragrafit 1 dhe nenit 30, paragrafit 5 të Ligjit Nr. 04/L-44 të KPM-së .....</i>	<i>27</i>
<i>Rastet e Shkeljes së Ligjit Nr. 04/L-44 të KPM-së, nenit 28 - Mos sjellja e Raportit Vjetor .....</i>	<i>27</i>
<i>Rastet për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-Vizuale KPM - 2013/03 .....</i>	<i>27</i>
<i>Rastet për shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM- 2013/01.....</i>	<i>27</i>
<i>Rastet për shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës .....</i>	<i>27</i>
<i>Rastet për shkeljen e Rregullores për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Tarifës për Licencë KPM-2014/03 - Mos pagesa e taksës për licencë .....</i>	<i>28</i>
<i>Rastet për shkeljen e Rregullores për Distribuim Kabllorë të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC-2007/04.....</i>	<i>28</i>
<i>Rastet për shkeljen e Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audio Vizuale KPM-2016/01, rastet të cilat janë paraqitur pas shfuqizimit të Rregullores CIMC-2007/04 dhe janë proceduar me këtë rregullore të re.....</i>	<i>28</i>
<i>Rastet e Shkeljes së Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenit 49, paragrafit 6 dhe 7, nenit 52, paragrafit 1, si dhe Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, nenit 9 paragrafit 7 .....</i>	<i>28</i>
<i>Rastet dhe Kërkesat tjera të proceduara nga KPM gjatë vitit 2016, Shkelja e Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale KKPM – 2010/01 dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës.....</i>	<i>29</i>
<b>DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR.....</b>	<b>35</b>
<i>Analiza e Spektrit Frekuencor – Transmetimet analoge.....</i>	<i>35</i>
<i>Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21).....</i>	<i>35</i>
<i>Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini).....</i>	<i>36</i>
<i>Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regional dhe lokal .....</i>	<i>36</i>

<i>Rastet për interferencë</i> .....	36
<i>Rastet për transmetime të palicencuara</i> .....	37
<i>Frekuencat e revokuara nga KPM</i> .....	37
<i>Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me KFOR</i> .....	37
<i>Kërkesa për ndryshim të lokacionit të transmetimit</i> .....	37
<i>Raste të ndryshimit të lokacionit të transmetuesit pa miratim të KPM-së</i> .....	38
<i>Ndryshimet në parametrat teknike dhe evidentimi i frekuencave të lira për licencime të reja të shërbimeve mediale audio (radio)</i> .....	38
<i>Plani frekuencor dhe dixhitalizimi</i> .....	38
<b>DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE</b> .....	<b>38</b>
<i>Buxheti</i> .....	38
<b>PUNA E BORDIT PËR ANKESA (BA)</b> .....	<b>41</b>
<i>Seancat dhe Vendimet e Bordit për Ankesa</i> .....	41
<b>OBJEKTIVAT E VITIT 2016:</b> .....	<b>42</b>
<b>OBJEKTIVAT E PARAPARA PËR VITIN 2017</b> .....	<b>42</b>
<i>REKOMANDIMET/SFIDAT E INSTITUCIONIT (PROBLEMET ME BUXHETIN, RRITJA E STAFIT)</i> .....	42
<i>Problemet me buxhetin</i> .....	42
<i>Nevoja për punëtorë të rinj</i> .....	42
<b>AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2015</b> .....	<b>43</b>
<i>Plani i Veprimit të Menaxhmentit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit të ZAP-it</i> .....	43
<i>Rekomandime nga Raporti i Auditimit të ZAP-it</i> .....	45

## SHTOJCAT

Shtojca I	Organogrami
Shtojca II	Tabela e Rasteve Ligjore
Shtojca IIIa	Raporti Vjetor Financiar
Shtojca IIIb	Raporti Vjetor Financiar

## **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Ky është raporti me aktivitetet e Komisionit të Pavarur të Mediave (në vazhdim KPM), për periudhën kohore janar-dhjetor 2016, të cilin ju përcjellim në pajtim me Ligjin 04/L44 për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Ashtu siç kërkohet nga Kuvendi, raporti është i ndarë në kapituj ku është bërë prezantimi i mandatit, kompetencave dhe përgjegjësive të KPM-së.

Raporti i punës së KPM për vitin 2016, përmban të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë periudhës kohore për të cilën raportohet, amandamentimi/miratimi i akteve nënligjore, bashkëpunimi i KPM-së me të licencuarit, bashkëpunimi me organizatat vendore e ndërkombëtare që veprojnë në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunimi me rregullatorët në rajon e më gjerë. Po ashtu, në raport është dhënë një përmbledhje e pasqyrës së pajtueshmërisë së shërbimeve mediale audio-vizuele të licencuara nga KPM-ja, me ligjin dhe të gjitha aktet nënligjore të KPM-së, statistikën e numrit të të licencuarve, rastet ligjore të proceduara, shfrytëzimi i spektrit frekuencor në territorin e Republikës së Kosovës, raporti financiar si dhe veprimet e ndërmarra për gjetjet dhe rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin paraprak.

Edhe për vitin 2017, prioritet i KPM-së mbetet implementimi i procesit të dixhitalizimit sipas Ligjit Nr. 04/L44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Ligjit Nr. 05/l-027 për Digjitalizimin e Transmetimeve Radio Difuzive Tokësore, zhvillimi i pluralizmit medial që u shërben gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, harmonizimi i akteve nënligjore dhe hartimi i akteve të reja nënligjore që rrjedhin si obligim nga procesi i dixhitalizimit, në harmoni me rregullativën evropiane si dhe zhvillimi i politikës së transmetimit.

**Mars 2017**

**KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE**

## KORNIZA LIGJORE

KPM është organ kushtetues i përcaktuar me nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Është themeluar me Ligjin Nr. 04/L-44 për KPM-në i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2 mars 2012 dhe i cili ka hyrë në fuqi më 20 prill 2012.

Me nenin 3, paragrafin 2.8 të Ligjit për KPM-në përcaktohet që: “KPM-ja i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës, deri me 31 mars të vitit vijues një raport vjetor, duke përfshirë edhe të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave dhe të ankesave, sanksionet që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit si dhe objektivat për vitin e ardhshëm. Raporti vjetor duhet të bëhet publik pas miratimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës”.

## PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

KPM është organ i pavarur, kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audio-vizuele.

### *Misioni i KPM-së është:*

- Të nxisë dhe të mbajë një sistem të drejtë dhe të hapur për licencimin dhe rregullimin e shërbimeve mediale audio-vizuele dhe për menaxhimin e spektrit të frekuencave të transmetimit në pajtim me standardet më të mira ndërkombëtare;
- Të kontribuojë në profesionalizimin e shërbimeve mediale audio-vizuele;
- Të mbështes lirinë dhe pluralizmin e shërbimeve mediale audio-vizuele.

## ORGANIZIMI INSTITUCIONAL

### *Përbërja dhe mandati i anëtarëve të KPM-së*

Sipas Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, KPM-ja përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, të cilët duhet të jenë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme si: kultura, arti, drejtësia, kinematografia, gazetaria, biznesi, menaxhmenti, marrëdhënie me publikun, marrëdhënie ndërkombëtare, media dhe teknologjia informative.

Procedura për emërimin e anëtarëve të KPM-së bëhet sipas nenit 11 pika 2.1. të Ligjit për KPM-në, i cili përcakton se: “brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të KPM-së apo

pas shpalljes së vendit të lirë për arsye të tjera, KPM nxjerr shpalljen publike, brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj”.

### *Nominimet e anëtarëve të KPM-së*

Bazuar në nenin 11, pika 2.1, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, KPM ka bërë ftesë publike për nominime për dy anëtarë të KPM-së. Ftesa publike është bërë më 12 janar 2016, mirëpo për shkak që nuk ka pas numër të mjaftueshëm të nominimeve, KPM ka vendosur për shtyrjen e afatit të pranimit të nominimeve deri më 10 shkurt 2016. Të gjitha nominimet e pranuar, KPM sipas procedurës i ka përcjell në Kuvend. Kuvendi i Republikës së Kosovës në seancën e mbajtur më 28 prill 2016, ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit Ad-Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe ka rizgjedhur në mandatin e tyre të dytë znj. Anita Morina SARAÇI dhe z. Abit HOXHA.

Në vitin 2016, është zhvilluar edhe një procedurë për emërimin e një anëtari të KPM-së. Ftesa publike është bërë më 4 korrik deri me 18 korrik 2016. Mirëpo, edhe në këtë rast, për shkak që nuk ka pas numër të mjaftueshëm të nominimeve, KPM ka vendosur për shtyrjen e afatit të pranimit të nominimeve deri më 5 gusht 2016. Të gjitha nominimet e pranuar, KPM sipas procedurës i ka përcjell në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës në seancën e mbajtur më 17 nëntor 2016ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit Ad Hoc për përzgjedhjen e kandidatit për anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe ka rizgjedhur në mandatin e tij të dytë z. Xhemajl KRASNIQI anëtar të KPM-së.

### *Përbërja e KPM-së gjatë vitit 2016*

Emri	Mbiemri	Pozita	i/e emëruar	Kohëzgjatja e mandatit
<b>Adnan</b>	MEROVCI	Kryetar	më 19 mars 2014	mandat 4 (katër) vjeçar
<b>Abit</b>	HOXHA	Nënkryetar	28 prill 2016	mandat 2 (dy) vjeçar
<b>Anita</b>	MORINA-SARAÇI	Anëtare	28 prill 2016	mandat 2 (dy) vjeçar
<b>Driton</b>	QERIQI	Anëtar	më 19 mars 2014	mandat 3 (tre) vjeçar
<b>Xhemajl</b>	KRASNIQI	Anëtar	17 nëntor 2016	mandat 4 (katër) vjeçar
<b>Jelena</b>	SIMIQ	Anëtare	më 12 mars 2015	mandat 3 (tre) vjeçar
<b>Mejdin</b>	SALIJI	Anëtar	më 12 mars 2015	mandat 3 (tre) vjeçar



- z. Adnan MEROVCI është ri-zgjedhur Kryetar i KPM-së në mbledhjen e KPM-së të mbajtur më 9 mars 2016.
- z. Abit HOXHA është zgjedhur Nënkryetar i KPM-së në mbledhjen e KPM-së të mbajtur më 4 tetor 2016.

Mandati i anëtarëve të KPM-së përcaktohet me short në bazë të nenit 13, paragrafit 2, të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në.

## AKTIVITETET E KPM-së

Gjatë kësaj periudhe kohore për të cilën raportohet, në bazë të obligimeve ligjore, KPM-ja ka mbajtur gjashtëmbëdhjetë (16) mbledhje të rregullta, në të cilat ka shqyrtuar dhe ka marrë vendime për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për KPM-në të cilat janë të paraqitura në këtë raport.

Më poshtë në mënyrë kronologjike janë të paraqitura mbajtja e mbledhjeve dhe marrja e vendimeve nga KPM-ja.

Më 5 janar 2016, KPM ka mbajtur mbledhjen e parë ku ka shqyrtuar rastet e mos pagesës së taksës së licencës nga të licencuarit të cilët edhe përkundër mundësisë së pagesës me afate shtesë kanë dështuar në kryerjen e obligimit ligjore. Për më shumë rreth këtyre rasteve shih *Shtojcën I, Paraqitja Tabelare e Rasteve Ligjore*.

Më 11 shkurt 2016, KPM ka mbajtur mbledhjen e dytë, në të cilën ka marrë vendime për dy (2) raste të licencimit: OSHP TV Dielli – heqje dorë nga licenca dhe OK Kumanova – ndërrim i statusit të biznesit nga NPT në SHPK.

KPM, po në këtë takim ka marrë vendim me masë sanksionuese **Vërejtje**, edhe për 6 raste ligjore për shkelje të legjislacionit sekondar të KPM-së:

1. TV SYRI VISION -shkelja e Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuele KPM 2013/03;
2. TV Liria -shkelja e Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuele KPM 2013/03;
3. KTV -shkelja e Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve KPM2013/01;
4. Klan Kosova -shkelja e Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuele KPM 2013/03;
5. TV TEMA -shkelja e Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuele KPM 2013/03 dhe;
6. TV PRIZRENI- shkelja e Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuele KPM 2013/03.

Me 9 mars 2016, KPM ka mbajtur mbledhjen e tretë dhe ka marrë vendim që të dërgojë në diskutim publik Draft Rregulloren për Shpërndarjen e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audio Vizuale. Gjithashtu në këtë mbledhje ka marrë vendim për miratimin e kërkesave lidhur me këto raste:

1. OSHP TV Dielli – kërkesë për licencë;
2. OSHP Premium TV – kërkesë për licencë dhe;
3. Radio Kent FM – kërkesë për ndryshim të lokacionit të transmetuesit dhe kategorisë.

Më 31 mars 2016, KPM ka mbajtur mbledhjen e katërt, në të cilën ka miratuar Raportin Vjetor të Punës së KPM-së për vitin 2015, i cili më pas është dërguar në Kuvendin e Republikës së Kosovës për miratim. Gjithashtu në këtë mbledhje KPM ka emëruar znj. Naile SELIMAJ-KRASNIQI Kryeshefe Ekzekutive të KPM-së me një mandat 3 vjeçar. Emërimi është bërë në pajtim me Ligjin për KPM-në Nr. 04/L-44, nenin 18, paragrafin 1, Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe bazuar në Rregulloren Nr. 06/2012 për Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Më 21 prill 2016, KPM ka mbajtur mbledhjen e pestë, ku ndër të tjera ka shqyrtuar përcaktimin e kriterëve për vazhdimin e licencës për një numër të radiove që u përfundon licenca gjatë viti 2016 dhe lidhur me vazhdimin e punës në hartimin e akteve nënligjore që dalin nga procesi i dixhitalizimit.

Gjithashtu në këtë mbledhje KPM ka miratuar këto vendime në 3 raste të licencimit:

1. Ofrues i Shërbimit Programor Metro TV – kërkesë për heqje dorë nga licenca
2. Operator Kabllor TV Kosova News – kërkesë për heqje dorë nga licenca
3. Operator Kabllor KDS Tele Star – kërkesë për ndërrim të pronësisë

Më 2 qershor 2016, KPM ka mbajtur mbledhjen e gjashtë me radhë. Në këtë mbledhje KPM ka marrë vendime për miratimin e kërkesave në 2 raste të licencimit:

1. Operator Kabllor Negenet– kërkesë për ndërrim të pronësisë
2. Ofrues i Shërbimit Programor Kujtesa Net SHPK– heqje dorë nga licenca për 8 OSHP ( K Film 1, K Film 2, K Film 3, K Film 4, K Film 5, K Doku 1, K Doku 2, K Realty).

KPM, po në këtë mbledhje, ka marrë vendim me masë sanksionuese ***Pezullim i licencës për 3 muaj***, në një (1) rast ligjor për shkelje të legjislacionit sekondar të KPM-së:

1. Operator Kabllor Kosova Net- shkelje e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës – E drejta e autorit

Më 21 qershor 2016, KPM ka mbajtur mbledhjen e shtatë, ku ka miratuar për konsultim publik Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale dhe Rregulloren KPM 2013/03 për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuale. Po në këtë mbledhje KPM ka marrë vendime për miratimin e kërkesave në 2 raste të licencimit

1. TV Prizreni - ndryshim i skemës programore dhe;
2. Operator Kabllor Dioni Net – heqje dorë prej licencës.

Më 30 qershor 2016, KPM ka mbajtur mbledhjen e tetë, ku ka marrë vendim për dhënien e licencës për transmetim me radio frekuencë për tri radio, dy prej tyre në Prishtinë: Radio Prishtina dhe Radio Kiss FM, ndërsa një në Gjilan: Radio Gjilani. Ndërsa për komunën e Hanit të Elezit nuk ka pasur aplikime për radio licencë.

Këto janë rastet e licencimit të miratuara në këtë mbledhje:

1. Operator Kabllor Kosova Net – heqje dorë prej licencës;
2. Vendim për licencimin e Radio Prishtina;
3. Vendim për licencimin e Radio Radio Kiss FM dhe;
4. Vendim për licencimin e Radio Gjilani

Më 13 korrik 2016, KPM ka mbajtur mbledhjen e nëntë, ku ka shqyrtuar përcaktimin e kriterëve për listën e kanaleve në Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audio Vizuale si dhe ka shqyrtuar draftet e rregulloreve lidhur me procesin e dixhitalizimit që ishin duke u hartuar.

Më 15 korrik 2016, KPM ka mbajtur mbledhjen e dhjetë, në të cilën ka shqyrtuar edhe një herë draftin final dhe me pas ka nxjerrë vendim për miratimin e Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audio Vizuale. Kjo rregullore ka hyrë në fuqi me 28 korrik 2016.

Më 28 korrik 2016, KPM ka mbajtur mbledhjen e njëmbëdhjetë, ku ka shqyrtuar rastet e kërkesave për vazhdimin e licencave që skadonin në 2016-tën. Po në këtë mbledhje janë shqyrtuar edhe komentet publike që KPM i ka pranuar gjatë periudhës 15 ditore të konsultimit publik, lidhur me amandamentimin e Rregullores për Komunikimet Komerciale Audio-vizuele dhe Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale. Gjithashtu, në këtë mbledhje KPM ka miratuar për dëgjim publik, 5 draft rregullore të reja që dalin si obligim nga procesi i dixhitalizimit, respektivisht Ligji për Digjitalizimin e Transmetimeve Tokësore Radiodifuzive.

Më 8 shtator 2016, KPM ka mbajtur mbledhjen e dymbëdhjetë, ku është miratuar amandamentimi i Rregullores për Komunikime Komerciale Audio Vizuale KPM-, ndërsa është shqyrtuar dhe fillimi i amandamentimit të Rregullores për Tarifën e Licencës.

Gjithashtu, në këtë mbledhje, KPM shqyrtoi dhe mori vendim për 4 raste të licencimit:

1. OK Miranda – heqje dorë nga licenca;
2. Radio Dukagjini – ndryshim i lokacionit të sistemimit të transmetimit;
3. Radio Kosova 1 ndryshim i lokacionit të sistemimit të transmetimit dhe;
4. Radio Kosova 2 – ndryshim i lokacionit të sistemimit të transmetimit;

Më 4 tetor 2016, KPM ka mbajtur mbledhjen e trembëdhjetë në të cilën ka miratuar Kodin e Etikës për Shërbimet Mediale Audio Vizuale në Republikën e Kosovës. Po ashtu, në këtë mbledhje KPM ka marrë vendim që të dërgojë për diskutim publik draftin e amendamentuar të Rregullores për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Tarifës së Licencës. KPM në këtë mbledhje ka shqyrtuar një rast ligjor/ankesë e palës kundër një shërbimi medial audiovizuel ku është miratuar ankesa dhe pala është sanksionuar me masën Vërejtje, për shkelje të legjislacionit të KPM.

Gjithashtu në këtë mbledhje KPM shqyrtoi dhe mori vendim për 2 raste të licencimit:

1. Radio Vala 2000 kërkesë për ndërrimin e pronësisë;
2. Ballkan TV – kërkesë për vazhdimin e skemës së ndryshuar programore edhe për 4 muaj tjerë;

Më 21 tetor 2016, KPM ka mbajtur mbledhjen e katërbëdhjetë me radhë, ku pas përfundimit të të gjitha procedurave të parapara ligjore ka miratuar logon e re të institucionit. Kjo logo është prezantuar para publikut për herë të parë me 27 tetor 2016, në manifestimin e organizuar nga KPM për nder të 10 vjetorit.

Më 25 nëntor 2016, KPM ka mbajtur mbledhjen e pesëmbëdhjetë, ku ka shqyrtuar dhe miratuar për dëgjim publik këto draft rregullore:

- Draft Rregullore për Operatorin e Multipleksit në Nivel Shtetëror;
- Draft Rregullore për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audio Vizuale;
- Draft Rregullore për Tarifën Vjetore për Licencë;
- Draft Rregullore për Bartjen e Detyrueshme të ofruesve të Shërbimeve Mediale në Operatorin e Multipleksit dhe;
- Draft Rregullore për Renditjen Logjike të Kanaleve

Gjithashtu në këtë mbledhje KPM shqyrtoi dhe mori vendim për 3 raste të licencimit:

1. Rekomandimet për licencim të operatorit IPTV Fiber Link;
2. OSHP Tribuna Channel-ndryshim i skemës programore;
3. TV Puls- ndryshim i skemës programore;

Ndërsa është marrë vendim edhe për ripërtëritjen e licencave për 36 radio të cilave u ka skaduar afati i licencës në muajin tetor 2016.

Më 28 dhjetor 2016, KPM ka mbajtur mbledhjen e gjashtëmbëdhjetë, ku ka shqyrtuar dhe marrë vendime në dy raste (ankesa) ligjore, të cilat janë hedhur poshtë si të pabazuara. Kjo pasi që KPM gjatë shqyrtimit të rasteve nuk ka gjetur se ka shkelje të legjislacionit të KPM-së.

Gjithashtu në këtë mbledhje KPM shqyrtoi dhe mori vendim për 4 raste të licencimit:

1. Telekom i Kosovës - rekomandim për licencim të IPTV;
2. Tel Communications/Prizren - rekomandim për licencim të IPTV;
3. Dot Net/Shtime - rekomandim për licencimin e operatorit të shpërndarjes dhe;
4. Radio Theranda - Radio Maria, kandidat për pronar të ri - rekomandim për ndërrim të pronësisë

#### ***Vendimet e KPM-së në vitin 2016:***

- 2 vendime për licencimin e OSHMA-ve të cilët transmetojnë përmes OSH;
- 4 vendime për licencimin e operatorëve të shpërndarjes (prej tyre 3 me platformën IPTV);
- 4 vendime për ndryshimin e pronësisë (në dy raste me vendime për ndryshim të pronësisë janë ndryshuar edhe emrat e subjekteve sipas kërkesave);
- 3 vendime për ndryshimin e parametrave teknike të licencës;
- 8 vendim për ndërprerje të licencës – Radio (1) OSHMA përmes OSH (4) dhe Operatorë të Shpërndarjes (3);
- 4 vendime për ndryshimin e skemës programore dhe;
- vendim për ndryshimin e licencës si pasojë e ndryshimit të emrit dhe tipit të biznesit.

## **PUNA NË HARTIMIN DHE AMANDAMENTIMIN E AKTEVE NËNLIGJORE**

Në kuadër të përmbushjes së obligimeve ligjore që dalin nga Ligji për KPM-në Nr. 04/L-44 dhe Ligji Nr. 05/1-027 për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radio Difuzive Tokësore, KPM ka vazhduar punën për amandamentimin/hartimin e akteve nënligjor duke respektuar të gjitha procedurat e parapara ligjore për krijimin e legjislacionit sekondar.

### ***Konsultimet publike lidhur me aktet nënligjore të KPM-së***

Më 25 janar 2016, KPM ka organizuar dëgjimin publik me qëllim të vënies në dispozicion të publikut dhe palëve të interesuara draft Rregulloren për Shpërndarjen e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audio-vizuele. Drafti i kësaj rregulloreje është vënë për konsultim publik prej 27 tetor 2015 deri më 20 nëntor 2015, dhe palët e interesit i kanë dërguar komentet e tyre në KPM. KPM i ka shqyrtuar të gjitha komentet dhe ato që kanë qenë të argumentuara në bazë ligjore, i ka vendosur në draft rregullore. Po ashtu më 14 qershor 2016, KPM organizoi për të dytën herë me radhë dëgjim publik lidhur me draft rregulloren në fjalë me qëllim që të miratojë një rregullore sa më gjithëpërfshirëse dhe që do ti zgjidhte problemet e industrisë së medieve në këtë fushë. Konsultimi publik i fundit ka qenë i hapur prej 10 mars 2016 deri më 30 mars 2016.

KPM më 15 korrik 2016 ka organizuar një dëgjim publik lidhur me amandamentimin e akteve nënligjore, respektivisht: Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale, Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuele dhe draft Rregulloren për Shpërndarjen e Shërbimeve

Mediale Audio dhe Audio-vizuale. Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale dhe Rregullorja për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuale kanë qenë në konsultim publik prej datës 27 qershor 2016 deri më 15 korrik 2016.

Prej datës 5 tetor 2016 deri më 25 tetor 2016 KPM ka vënë në konsultim publik Draft Rregulloren për Tarifën për Licencë.

Prej datës 16 gusht 2016, deri më 16 shtator 2016 KPM ka vënë në konsultim publik draft rregulloret e reja për procesin e kalimit në transmetim digjital:

- Draft Rregulloren për Renditjen Logjike të Kanaleve Televizive të Licencuara nga KPM;
- Draft Rregulloren për Bartjen e Detyrueshme të Ofruesve të Shërbimeve Mediale në Operatorin e Multipleksit;
- Draft Rregulloren për Operatorin e Multipleksit; dhe
- Draft Rregulloren për Ofruesit e Shërbimeve Mediale

Dëgjimin publik për aktet e lartcekura është mbajtur më 5 dhjetor 2016. KPM ka finalizuar punën rreth miratimit të këtyre akteve nënligjore dhe ka planifikuar që të njëjtat të miratohen në fillim të janarit të viti 2017.

Pas përfundimit të procedurave të parapara me ligj për nxjerrjen e legjislacionit sekondar (neni 8 i Ligjit për Nr. 04/L-44 KPM-në), duke ua vënë kështu në dispozicion përfaqësuesve të shërbimeve mediale audio-vizuale dhe palëve tjera të interesit për të ofruar komente me shkrim lidhur me këto akte nënligjore, KPM gjatë vitit 2016 ka amandamentuar dhe ka miratuar këto akte nënligjore:

- Rregullore për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audio Vizuale KPM – 2016/01
- Rregullore për Komunikimet Komerciale Audio-vizuale KPM – 2016/02
- Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KPM - 2016/03 si dhe
- Forma e Aplikimit për Operator të Shpërndarjes

## **RIPËRTËRITJA E LICENCAVE PËR RADIO STACIONET TË CILAVE U SKADON LICENCA GJATË VITIT 2016**

KPM në vitin 2009 dhe 2010 ka bërë licencimin afatgjatë për ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale me transmetim tokësor. Gjatë vitit 2016, afati 7 vjeçar i licencave për një numër të konsiderueshëm të radio stacioneve (62 radio stacione) do të përfundonte. Lidhur me këtë, KPM ka njoftuar me kohë të gjithë këta të licencuar për afatet ligjore për parashtrimin e kërkesave për ripërtëritje të licencës dhe ka pranuar kërkesat nga këto subjekte të licencuara në vitin 2009.

E drejta e ripërtërimit dhe afatet për të parashtruar kërkesën për ripërtëritje të licencës së KPM-së është e përcaktuar me Nenin 25 të Ligjit të KPM-së, i cili thekson:

*“Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtërihet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audiovizuel privat për sa u përket kushteve dhe kriterëve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Zyra Ekzekutive brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës”.*

Për vazhdimin e licencës, KPM ka bërë vlerësimin e pajtueshmërisë së të licencuarve me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, për periudhën efektive të vlefshmërisë së licencës të shërbimeve mediale audio (radiostacionet).

KPM ka marrë vendim që t’u ripërtërihet licenca të gjithë të licencuarve të cilët kanë vepruar në pajtueshmëri me bazën ligjore. Bazuar në këtë vendim KPM ka lëshuar edhe vendimet individuale për të licencuarit në faza të ndryshme. Afatet e ripërtërimit të licencës kanë qenë më 28 gusht 2016, më 6 tetor 2016, më 30 tetor 2016 dhe më 30 dhjetor 2016.

### **LICENCIMI PËR TRANSMETIMIN E PROGRAMEVE NË RADIO, NË TRI (3) KOMUNA TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

KPM ka bërë një vlerësim rreth nevojës dhe mundësive frekuencore për shpalljen e konkursit publik për dhënien e licencave të reja në bazë të frekuencave të lira, me theks të veçantë, në ato komuna të Republikës së Kosovës ku ka mungesë të shërbimeve mediale radio me mbulim lokal, si dhe në ato komuna ku është kërkuar që të krijohet mundësi për pluralizëm medial.

Fillimisht, KPM ka identifikuar mundësitë teknike për frekuenca të lira, të cilat janë në pajtim me planin frekuencor të Republikës së Kosovës dhe që të njëjtat mund të dalin në konkurs për dhënien në shfrytëzim kandidatëve që i plotësojnë kriteret konkurruese më së miri.

Ky vlerësim është bërë duke u bazuar në Ligjin për KPM-në, respektivisht nenin 9 të këtij ligji, i cili përcakton Politikën e Transmetimit në Republikën e Kosovës. Komunat për të cilat është bërë shpallja e frekuencave të lira për licencimin e radio stacioneve, sipas kërkesave dhe nevojave të qytetarëve të Republikës së Kosovës janë: Prishtina, dy (2) radio frekuenca regjionale, Gjilani, një (1) radio frekuencë lokale dhe Hani i Elezit, një (1) radio frekuencë lokale.

Kjo shpallje është bërë në bazë të nenit 21, 22 dhe 23 të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në dhe për këtë Komisioni i Pavarur i Mediave mori vendim në mbledhjen e datës 31 mars 2016.

## **BASHKËPUNIMI ME AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIO-VIZIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Më 25 mars 2016, një delegacion i KPM-së i udhëhequr nga Kryetari z. Adnan MEROVCI ka qëndruar në Republikën e Shqipërisë ku është takuar me një delegacion të Autoritetit të Mediave Audio-vizive (AMA) të Republikës së Shqipërisë, të udhëhequr nga z. Sami Nezaj-Zëvendëskryetar i Autoritetit. Me këtë rast KPM dhe AMA kanë diskutuar për avancimin e bashkëpunimit reciprok në fushën e rregullimit audio-viziv. Temat kyçe ishin procesi i dixhitalizimit dhe harmonizimi i legjislacionit sekondar për operatorët e autorizuar për ripërsëritjen e programeve audio/audiovizive. Po ashtu në takim është diskutuar edhe për përvojat e të dyja vendeve lidhur me rregullimin e funksionimit të operatorëve të shpërndarjes së përmbajtjeve audio-vizuale, mënyrës së tarifimit të tyre, përcaktimit të zonës së mbulimit etj., si dhe për probleme të përbashkëta si ajo e të drejtës së autorit edhe matja e audiencës.

### **BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA VENDORE**

#### ***Bashkëpunimi me Autoritetin Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP)***

Edhe në vitin 2016, KPM ka vazhduar bashkëpunimin me ARKEP. Në kuadër të këtij bashkëpunimi KPM duke u bazuar edhe në obligimet që dalin nga Ligji për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radio Difuzive Tokësore, ka organizuar takim me menaxhmentin e ri të ARKEP-it ku janë diskutuar pika të ndryshme rreth çështjes së dixhitalizimit.

Nga bashkëpunimi me ARKEP është rënë dakord që të hartohet një marrëveshjeve bashkëpunimi mes dy institucioneve rregullatorë në fushat që janë veprimtari e përbashkët siç është dixhitalizimi i transmetimeve dhe pika tjera. Marrëveshja për bashkëpunim është kodifikuar në një dokument i cili është ende draft.

#### ***Bashkëpunimi me Zyrën për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta në kuadër të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve (MKRS)***

***Bashkëpunimi me Zyrën për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta në kuadër të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve (MKRS), shoqatat për menaxhimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta në fushën audio- vizuale dhe atë të muzikës APIK dhe VAPIK***

Duke pas për bazë obligimet që dalin nga Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, KPM ka përgjegjësi të përcjellë punën e të licencuarve për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre karshi obligimeve për sigurimin e marrëveshjeve valide për të drejtat e autorit dhe të drejtat e transmetimit e ritransmetimit. E rëndësishme është që të ketë zbatueshmëri sa më të madhe të përcaktimeve ligjore që janë bërë.



Lidhur me këtë, më 23 qershor 2016, KPM ka kontribuar duke qenë nikoqire e organizimit të takimeve të ndara me të licencuarit e KPM-së (Televizione, Ofrues të Shërbimeve Programore, Radio dhe Operatorë Kabllorë) përfaqësuesit e Zyrës për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe përfaqësuesit e Shoqatave për Menaxhim Kolektiv të të Drejtave të Autorit, APIK dhe VAPIK.

Në këtë takim, shoqatat për menaxhimin kolektiv të të drejtave të autorit kanë prezantuar punën dhe obligimet e tyre ligjore si dhe kanë diskutuar për fillimin e negocimit për tarifën dhe orientimin drejt nënshkrimit të një marrëveshjeje kolektive, përmbushjen e obligimeve dhe përgjegjësi nga ana e shërbimeve mediale audio-vizuale për transmetimin dhe ritransmetimin e programeve, siç përcaktohet me Ligjin për Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

## **BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE**

### *Bashkëpunimi me Zyrën e UNICEF-it në Kosovë*

Në kuadër të bashkëpunimit me Zyrën e UNICEF-it në Kosovë, KPM më 22 mars 2016, nën kryesimin e Kryetarit z.Adnan MEROVCI ka zhvilluar një takim me Shefen e UNICEF-it në Kosovë, znj. Liala Omar Gad. Në këtë takim KPM ka njoftuar lidhur me aktivitetet më të rëndësishme të KPM-së, në përmbushje të obligimeve kushtetuese e ligjore. Me interes të veçantë për të dyja palët në këtë takim është diskutuar mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet mediale audio vizuale.

Në takimit është dakorduar që të dyja palët të vazhdojnë bashkëpunimin lidhur me amandamentimin e akteve nënligjore të KPM, respektivisht Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio Vizuale dhe Kodint të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio Vizuale.

## **BASHKËPUNIMI ME FONDACIONIN THOMPSON**

Lidhur me aktivitetet e realizuara përmes projektit “Media for All – Strengthening Media Self Regulation, Media Law and Media Freedom in Kosovo”, Projekt i financuar nga BE e i menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë – Implementuar nga Fondacioni Thompson (EU funded project managed by European Union Office in Kosovo - Implemented by Thomson Foundation), gjatë vitit 2016, janë zhvilluar dy aktivitete:

Fillimisht, në kuadër të këtij projekti, KPM ka angazhuar një ekspert ndërkombëtar lidhur me rishikimin e Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale.

Eksperti ka zhvilluar takime me përfaqësues të Zyrës Ekzekutive të KPM-së për tri ditë (28-30 mars 2016), gjatë së cilave është diskutuar rreth këtij Kodi. Po ashtu, eksperti ka zhvilluar takime edhe me përfaqësues të medieve si KTV, RTK2, Klan Kosova dhe AMPEK, me të cilët ka diskutuar kryesisht rreth sfidave, vështirësive që kanë në implementim të këtij Kodi. Pas këtyre takimeve dhe diskutimeve, eksperti ka dërguar rekomandimet për ndryshim/amandamentim të këtij Kodi.

Po ashtu, prej datës 14-20 mars 2016, është realizuar një udhëtim studimor në Strasburg, që ka përfshirë pjesëmarrjen në një seancë gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, takime në Këshill të Evropës, në Zyrën e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut dhe takime të tjera. Në të gjitha këto takime janë adresuar çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e lirisë së shprehjes. Nga 8 pjesëmarrës nga Kosova, një prej tyre ka qenë përfaqësues nga KPM.

### ***PJESËMARRJA E KPM-SË NË KONFERENCËN E EPRA-SË (PLATFORMA EVROPIANE E AUTORITETEVE RREGULLATIVE) 25-27 MAJ 2016 BARCELONË /SPANJË***

Konferenca e EPRA-s është mbajtur më datat 25 deri më 27 maj 2016. KPM është anëtare e EPRA-s që nga viti 2003. Natyra e konferencës së EPRA-së është e karakterit të shkëmbimit të përvojave në fushën e rregullimit të mediave, në mes të anëtarëve të kësaj organizate, sfidave me të cilat përballen në këtë fushë, si dhe ofrimin e alternativave për zgjidhjen e këtyre sfidave bazuar në përvojat e ndryshme. Ky ishte takimi i 43-ti me radhë i takimeve të rregullta të EPRA-së ( të cilat organizohen dy herë në vit), nikoqir i së cilës kësaj radhe ishte rregullatori i mediave në Spanjë. Pjesëmarrës të kësaj konference dy ditore ishin përfaqësuesit e rregullatorëve nga më shumë se 50 vende, anëtare të EPRA-së, përfaqësuesit e institucioneve relevante evropiane , përfaqësues të instituteve dhe organizatave të ndryshme të cilët merren me fushën e mediave, në mesin e tyre edhe përfaqësuesit e KPM. Përfaqësuesit e KPM-së ishin pjesëmarrës në zhvillimin e punimeve të dy sesioneve plenare të konferencës dhe në grupet punuese.

### ***RAPORTIMI I KPM-së NË TAKIMIN E DIALOGUT TË PROCESIT TË STABILIZIM ASOCIIMIT***

Në kuadër të takimit të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA) për “Inovacion, Kapital Njerëzor, Politika Sociale dhe Shoqëri Informativë” KPM ka marrë pjesë në dy takime të mbajtur më 25 dhe 27 janar 2016 dhe 15 dhjetor 2016 në Bruksel. Në këto takime përfaqësuesit e KPM-së kanë raportuar për zhvillimet institucionale, ecurinë e punës dhe vështirësitë e ndryshme që KPM po përballlet në lidhje me plotësimin e kriterëve të BE-së siç janë: përfundimi i procesit të dixhitalizimit të transmetimeve tokësore radio difuzive, harmonizimi i akteve nënligjore të KPM-së me Direktivën për Shërbimet Mediale Audiovizuale (AVMS), hartimi i akteve të reja nënligjore që dalin si obligim nga Ligji për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radio Difuzive Tokësore.

KPM ka raportuar edhe lidhur me problemet tjera me të cilat po ballafaqohet institucioni për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore, u në kuadër të të gjitha detyrave dhe veprimeve të lartcekura, buxheti i KPM-së është zero si tek hartimi dhe amandamentimi i legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian ashtu edhe tek procesi i dixhitalizimit të transmetimeve tokësore radiodifuzive.

## PUNA E ZYRËS EKZEKUTIVE

Në kuadër të KPM-së funksionon Zyra Ekzekutive si organ i dytë i këtij institucioni të pavarur. Zyra Ekzekutive udhëhiqet nga Kryeshefja Ekzekutive, e cila e ndihmon Komisionin e KPM-së në realizimin e detyrave dhe përgjegjësisive sipas Ligji Nr. 04/L-44 për KPM-në.

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44, Kryeshefja Ekzekutive menaxhon:

- me nëpunësit civilë të KPM-së;
- me financat dhe me burimet tjera të financimit;
- ofron këshilla për politikat e KPM-së;
- siguron zbatimin e vendimeve, politikave dhe masave tjera të KPM-së në mënyrë efektive si dhe;
- bënë koordinimin e punëve me institucionet tjera.

Në kuadër të Zyrës Ekzekutive operojnë 4 departamente për Rregullimin e Transmetimit dhe Departamenti i Administratës dhe Prokurimit (*Shtojca I Organogrami*):

1. Departamenti i Monitorimit dhe Analizës;
2. Departamenti i Licencimit,
3. Departamenti Ligjor
4. Departamenti për Menaxhim Frekuencor
5. Departamenti i Administratës
6. Departamenti i Prokurimit.

### ***Burimet njerëzore***

Personeli i Zyrës Ekzekutive janë shërbyes civilë dhe janë të miratuara gjithsej 31 pozita. Kërkesat disavjeçare për ngritje të numrit të punonjësve nuk mirren parasysh nga ministria relevante. Pamundësia e ngritjes së kapaciteteve njerëzore në Zyrën Ekzekutive, respektivisht pamundësia e shtimit të numrit të personelit, vit pas viti po e vështirëson punën e KPM-së për faktin që obligimet dhe fusha e kompetencës po zgjerohet me rritjen e numrit të të licencuarve ndërsa stafi mbetet në numër të njëjtë dhe të pamjaftueshëm.

## **DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZAVE (DMA)**

Departamenti i Monitorimit dhe Analizave (DMA), gjatë vitit 2016, ka vlerësuar pajtueshmërinë e shërbimeve mediale audio-vizuale me rregulloret e KPM-së si dhe Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave, ndërsa gjatë fushatës për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura për Kryetar të Komunës së Drenasit ka vlerësuar pajtueshmërinë me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073 në Republikën e Kosovës.

Realizimi i aktiviteteve të poshtë shënuara dhe rekomandimet e këtij Departamenti, pas monitorimeve të bëra, ishin bazë mbi të cilat departamentet tjera të KPM-së kanë mbështetur veprimet e mëtutjeshme.

### ***Monitorimi i zgjedhjeve lokale për kryetar të Komunës së Drenasit***

Në mënyrë që të vlerësojë pajtueshmërinë e ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuale (OSHM) me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje, i cili përcakton dispozitat për Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve, Departamenti i Monitorimit dhe Analizës (DMA), ka bërë monitorimin e mbulimit të dy raundeve të zgjedhjeve lokale për Kryetar të Komunës së Drenasit, nga ana e ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuale,

Në monitorim janë përfshirë RTK1, TV 21, KTV, si dhe Ofruesit të Shërbimeve Programore:, Klan Kosova, Tribuna Channel dhe Star TV. Fokus i këtyre monitorimeve ishin edicionet e lajmeve, kronikat zgjedhore, intervistat, debatet dhe spotet politike në kohën e shikueshmërisë më të madhe, nga ora 16:00 deri 24:00. Gjatë monitorimit janë bërë matjet e hapësirës së dedikuar kandidatëve pjesëmarrës në këto zgjedhje si dhe mënyra e raportimit gjatë fushatës.

### ***Pajtueshmëria me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së - Pjesa 3 e Licencës***

Licenca e KPM-së përbënë një kontratë të detyrueshme për të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin për KPM-në, me kushtet dhe termet e saj si dhe me të gjitha Pjesët e tjera të Licencës së KPM-së.

Me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së OSHM-ve me Pjesën 3 të Licencës, Departamenti i Monitorimit dhe Analizës ka realizuar një projekt monitorimi gjatë të cilit ka vlerësuar nëse të licencuarit e KPM-së veprojnë në pajtueshmëri me Pjesën 3 të Licencës, që përmban Pjesën Programore. Ky monitorim i ka mundësuar KPM-së krijimin e një pasqyre më të saktë për pajtueshmërinë e subjekteve transmetuese me skemën programore, respektivisht me formatin e programit. Gjithashtu, monitorimi është bërë edhe me qëllim të përpilimit nga ana e KPM-së të listës së OSHMA-ve me statusin e bartjes së obligueshme në operatorët e shpërndarjes, siç përcakton neni 10.5 i Rregullores KPM-2016/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audio-vizuale.

Në këtë monitorim DMA ka përfshirë OSHM-të me mbulim nacional, regjional e lokal si dhe OSHM-të që operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes. Në kuadër të këtij projekti të monitorimit, janë shikuar, matur dhe analizuar formatet dhe strukturat programore të programit një javor të ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuale, të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme nga stafi monitorues. Gjetjet nga këto monitorime janë krahasuar pastaj me të dhënat në Pjesën 3 të Licencës, të cilën subjektet transmetuese e kanë paraqitur me rastin e aplikimit për licencë të KPM-së.

Vlerësimi për pajtueshmërinë me strukturën programore dhe formatin e programit është bazuar në përkufizimet e dhëna në Pjesën 3 të Licencës, sipas të cilave përmbajtjet programore ndahen në: Programe të Shërbimit Publik, Programe Argëtuese, Programe të Prodhimit të Vet, Programe të Ritransmetuara dhe Programe Komerciale nga Jashtë.

### *Të gjeturat nga Monitorimi*

Nga 21 monitorime të kryera për periudhën një javore, 10 kanë rezultuar në shkelje të Pjesës së 3-të të Licencës. Kjo, pasi që ndryshimet e bëra të ndonjë kategorie apo tipit të programit në shumicën e rasteve kanë tejkaluar *një të katërtën (25%) e ndonjë kategorie të Tipit të Programit ose të Burimit të Programit* siç përcakton neni 2.1 i Pjesës 3 të Licencës.

Gjithashtu, është vërejtur nga monitorimi se disa OSHM të cilat me rastin e aplikimit për licencë kanë bashkangjitur skema programore me lajme, intervista, emisione edukative, të sportit e dokumentarë, kanë bërë ndryshime të theksueshme të formatit të programit duke shtuar dukshëm sasinë e programeve muzikore (më shumë se 25%) ose duke eliminuar ndonjë kategori programore në dëm të programit të shërbimit publik.

### *Pajtueshmëria me Rregulloren KPM 2013/02 për të Drejtën e Autorit*

Gjatë vitit 2016 për vlerësimin e pajtueshmërisë me Rregulloren për të Drejtën e Autorit janë realizuar gjithsejtë shtatëmbëshjetë (17) monitorime të operatorëve të shpërndarjes dhe katër (4) monitorime për OSHM-të. Lidhur me transmetimin e programeve të caktuara e me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë me këtë rregullore, shërbimeve mediale audio-vizuale të monitoruara u janë kërkuar marrëveshjet valide për të drejtën e autorit. Vlerësimi i pajtueshmërisë me këtë rregullore është intensifikuar veçmas në periudhën e organizimit të kampionateve, ligave apo ndeshjeve të tjera sportive të organizuara gjatë vitit 2016.

### *Pajtueshmëria me Rregulloren KPM 2013/03 për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuale*

Në fokus të monitorimeve për pajtueshmërinë me këtë rregullore ishin: sasia e reklamave të transmetuara brenda një ore program, vendosja e produkteve, sponsorimet, teleshoppingu, reklamimi me ekran të ndarë si dhe dispozita tjera të kësaj rregulloreje. Lidhur me këtë rregullore janë realizuar pesë monitorime. Gjetjet nga këto monitorime kanë dëshmuar se dy OSHM kanë vepruar në kundërshtim me këtë rregullore.

Gjatë këtyre monitorimeve janë identifikuar shkelje të neneve 9.1,10.1, 10.2.3 dhe 13.3 të kësaj rregulloreje të cilat ishin shkeljet më të shpeshta të identifikuara, dhe të cilat kanë të bëjnë me dallimin e komunikimeve komerciale audio-vizuale nga pjesët tjera programore, kohëzgjatjen e reklamimit televiziv dhe teleshoppingut, sponsorizimin dhe vendosjen e produkteve.

### ***Pajtueshmëria me Rregulloren KPM 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale***

Me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së shërbimeve mediale audio-vizuale me këtë rregullore, janë monitoruar shërbimet mediale audio-vizuale me mbulim nacional, regjional e lokal si dhe ofruesit e shërbimeve programore. Lidhur me këtë rregullore janë realizuar tetë (8) monitorime, katër nga të cilat kanë rezultuar me shkelje të kësaj rregulloreje nga ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuale.

Shkeljet e neneve 3, 5, 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje janë shkeljet më të shpeshta të identifikuara gjatë monitorimit dhe kanë të bëjnë me kufizimet dhe obligimet e përgjithshme të shërbimeve mediale audio-vizuale si: kategorizimin e programeve, kohën e transmetimit të tyre si dhe përdorimin e shenjave dhe piktogrameve siç përcaktohet me këtë rregullore.

Është karakteristike të përmendet se shumica e shkeljeve janë bërë me rastin e reprizimit të programeve të natës, veçmas serialeve, ndërsa, është vërejtur edhe tendenca që shërbimet mediale audio-vizuale t'i kategorizojnë përmbajtjet programore në kategori më të ulëta, në mënyrë që ato t'i transmetojnë në orët më të hershme të mbrëmjes.

### ***Pajtueshmëria me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës***

Pajtueshmëria me Kodin Etikë për Ofruesit e Shërbimeve Mediale është vlerësuar kryesisht me rastin e ankesave nga publiku ose rasteve *ex officio* për shkelje të Kodit të Etikës, të ngritura nga KPM. Lidhur me Kodin e Etikës s për Ofruesit e Shërbimeve Mediale janë bërë 19 monitorime, 7 prej të cilave janë bërë pas ankesave të cilat pretendojnë për shkelje nga ana e shërbimeve mediale audio-vizuale.

DMA, ka bërë monitorime të detajuara dhe analiza lidhur me ankesat e pranuar për përmbajtje të caktuar programore si dhe rastet e inicuar *ex officio* nga KPM. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij departamenti pas shqyrtimit të ankesave lidhur me shkeljet e pretenduara si dhe hartimit të raporteve të monitorimit, ishin bazë mbi të cilat departamentet tjera kanë vazhduar me procedurat e mëtutjeshme.

### ***Pajtueshmëria me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale dhe Kushtet dhe Termat e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për Distribuimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë***

Departamenti i Monitorimit dhe Analizës (DMA) gjatë vitit 2016 ka realizuar një numër të konsideruar të aktiviteteve karshi objektivave të saj, për të mbikëqyrur zbatimin e legjislacionit të KPM-së nga ana

e të licencuarve të tij me statusin e operatorit të shpërndarjes (OSH). Miratimi i rregullores së re ka determinuar edhe aktivitetin e DMA-së për monitorimin e të licencuarve.

Çdo fillim vit, operatorët e shpërndarjes kanë obligim të deponojnë në KPM katalogët e azhurnuar të kanaleve si dhe marrëveshjet e reja për të drejtat e ritransmetimit të këtyre kanaleve dhe përmbajtjeve programore. Nga ky aktivitet DMA siguron të dhëna të përditësuara në lidhje me të drejtat e ritransmetimit të operatorëve të shpërndarjes, por edhe ofertën e tyre programore për qytetarët.

Gjatë vitit 2016, DMA ka kryer 61 monitorime lidhur me pajtueshmërinë e operatorëve të shpërndarjes. Nga ky numër, 18 monitorime janë bërë në bazë të ankesave nga industria. Këto ankesa për subjekt trajtimi kishin pajtueshmërinë e një numri të konsiderueshëm të operatorëve të shpërndarjes, por edhe operimeve ilegale apo pa licencë të KPM-së.

Lidhur me këto raste, DMA në bashkëpunim edhe me departamentet tjera ka realizuar monitorime në terren në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, duke verifikuar rastet e tilla, dhe më pas duke ndërmarrë veprime konkrete varësisht nga natyra e rasteve.

Raportet e monitorimit lidhur me shkeljet e gjetura të OSH janë proceduar për trajtim të mëtutjeshëm tek Departamenti Ligjor.

### *Vizitat/ Inspektimet*

Vizitat tek ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuale janë dëshmuar si formë e mirë e bashkëpunimit me to. Gjatë këtyre vizitave, stafi i KPM-së pati mundësinë të njoftohet për të arriturat e shërbimeve mediale audio-vizuale, për problemet dhe shqetësimet e tyre e gjithashtu edhe të vërtetojë vendndodhjen e transmetuesve, studiove, të vërtetojë nëse shërbimet mediale audio-vizuale mbajnë arkivën 21 ditore të programeve të transmetuara dhe nëse posedojnë të drejtat e autorit për programe të caktuara.

## **DEPARTAMENTI I LICENCIMIT**

### *Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës*

Departamenti i Licencimit është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për licenca të reja për ofrues të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, përfshirë edhe shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me ndryshime të kushteve dhe termeve të përgjithshme të licencës së KPM-së. Gjithashtu, Departamenti i Licencimit është përgjegjës për mirëmbajtjen e një regjistri për të gjithë të licencuarit e KPM-së. Kështu që, gjatë vitit 2016 kanë operuar gjithsej 20 TV stacione, 82 Radio stacione, 38 Operator të Shpërndarjes (3 prej tyre janë IPTV) dhe 48 Ofrues të Shërbimeve Mediale (OSHMA), të cilët ofrojnë programet e tyre vetëm përmes rrjetit të Operatorëve të Shpërndarjes.

Nga 20 shërbimet mediale televizive me transmetim tokësor të licencuara nga KPM-ja, tre (3) i përkasin kategorisë me mbulim nacional, dymbëdhjetë (12) me mbulim regjional dhe pesë (5) me mbulim lokal.

Kategorizimi është i bazuar në vendndodhjen e transmetuesve dhe parametrave teknik.

### ***Numri i TV dhe Radio stacioneve sipas gjuhëve:***

*Të licencuara 20 TV stacione:*

- 1 TV stacion publik;
- 13 TV stacione në gjuhën shqipe;
- 5 TV stacione në gjuhën serbe;
- 1 TV stacion në gjuhën turke.

*Të licencuara 82 Radio stacione*

- 2 radio stacione të transmetuesit publik;
- 47 radio stacione në gjuhën shqipe;
- 23 radio stacione në gjuhën serbe;
- 3 radio stacione në gjuhën boshnjake;
- 3 radio stacione në gjuhën turke;
- 2 radio stacione në gjuhën gorane;
- 1 radio stacion në gjuhën rome;
- 1 radio stacion multietnike.

### ***Numri Operatorëve të Shpërndarjes (OSH) të licencuar:***

*Të licencuar 38 operatorë të shpërndarjes:*

- 32 operatorë të shpërndarjes të licencuar me pronarë shqiptar;
- 2 operatorë të shpërndarjes të licencuar me pronarë goran;
- 4 operatorë të shpërndarjes të licencuar me pronarë serb.

### ***Ofruesit e Shërbimeve Mediale Adio dhe adiovizuale (OSHMA) të cilët transmetojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes***

*Gjithsej janë të licencuar 48 Ofrues të Shërbimeve Mediale Adio dhe Adiovizuale (OSHMA), të cilët ofrojnë programet e tyre vetëm nëpërmjet rrjetit të operatorëve të shpërndarjes.*

- 43 OSHMA janë të licencuar të transmetojnë program në gjuhën shqipe;
- 2 OSHMA është i licencuar të transmetojë program në gjuhën serbe ( OSHMA TV Centar dhe TV Kiss) dhe;
- 3 OSHMA janë të licencuar që transmetojnë program në kuadër të Transmetuesit Publik RTK (RTK 2; RTK News dhe RTK Art).



## ***Shqyrtimi i kërkesave***

Gjatë vitit 2016, Departamenti i Licencimit (D-LIC) ka regjistruar 37 raste për shqyrtim, e të cilat kanë të bëjnë me: kërkesa për licencë të OSHP-së, kërkesa për licencë të operatorëve kabllorë, kërkesa për ndryshim të lokacionit të transmetimit, kërkesë për ndryshimin e emrit të subjektit të licencuar, kërkesat për ndryshim të pronësisë, njoftime për heqje dorë nga licenca, ankesa për interferenca, refuzim ndaj kërkesave si të pa bazuara apo të pa kompletuara si dhe kërkesa që kanë të bëjnë me kushtet dhe termet e përgjithshme të licencës së KPM-së. Ndërsa, Departamenti i Licencimit ka pasur të bartura 6 raste për shqyrtim nga viti 2015 në vitin 2016.

D-LIC ka përgatitur rekomandimet për rastet e licencimit, të cilat i ka prezantuar para anëtarëve të KPM-së për shqyrtim dhe mbi bazën e atyre rekomandimeve janë marrë vendime.

Në përgjithësi, gjatë vitit 2016 janë marrë këto vendime për licencim:

- 2 vendime për licencimin e OSHMA-ve të cilët transmetojnë përmes OSH;
- 4 vendime për licencimin e operatorëve të shpërndarjes (prej tyre 3 me platformën IPTV);
- 4 vendime për ndryshimin e pronësisë (në dy raste me vendime për ndryshim të pronësisë janë ndryshuar edhe emrat e subjekteve sipas kërkesave);
- 3 vendime për ndryshimin e parametrave teknike të licencës;
- 8 vendim për ndërprerje të licencës – Radio (1) OSHMA përmes OSH (4) dhe Operatorë të Shpërndarjes (3);
- 4 vendime për ndryshimin e skemës programore;
- 1 vendim për ndryshimin e licencës si pasojë e ndryshimit të emrit dhe tipit të biznesit.

## ***Rastet të cilat janë mbyllur pa pasur nevojë për vendim të Komisionit, gjithsej janë 9:***

- 6 raste lidhur me ndërhyrjet në frekuencat e transmetimit;
- 1 rast për ndryshim të parametrave teknike;
- 1 rast lidhur me ndryshimin e pronësisë është mbyllur, për shkak të mungesës së dokumentacionit;
- 1 rast për ndryshim të skemës programore është mbyllur, për arsye të mungesës së dokumentacionit.

## ***Rastet që janë bartur për shqyrtim në vitin 2017, janë gjithsej 8 raste:***

- 1 kërkesë për ndryshimin e skemës programore;
- 2 kërkesa për licencë të operatorit të shpërndarjes;
- 2 kërkesa për licencë për Ofrues të Shërbimeve Mediale të cilët transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes;
- 1 kërkesë për ndryshimin e pronësisë;

- 1 njoftim për ndërprerjen e veprimtarisë së operatorit të shpërndarjes;
- 1 njoftim për ndërprerje të transmetimit pa njoftim paraprak të KPM-së.

### ***Licencimi i radio stacioneve të reja***

Pas përfundimit të konkursit për frekuenca të lira, i cili ka qenë i hapur nga data 14 prill 2016 deri më datën 16 maj 2016, janë themeluar dy komisione: Komisioni i Hapjes së Aplikacioneve i cili ka qenë i përbërë nga stafi i Zyrës Ekzekutive dhe Komisioni Vlerësues në kuadër të të cilit kanë qenë, përveç stafit të Zyrës Ekzekutive, edhe anëtarë të organit vendimmarrës - Komisionit të KPM-së.

Pas hapjes dhe vlerësimit të aplikacioneve është konstatuar se për komunat për të cilat është bërë shpallja për frekuenca të lira të radios kanë aplikuar:

- 9 kandidatë: për Komunën e Prishtinës,
- 2 kandidatë për Komunën e Gjilanit, ndërsa
- për Komunën e Hanit të Elezit nuk kishte asnjë kandidatë.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit të aplikacioneve, ku secili kandidatë është vlerësuar me pikë në pajtim me rregulloren e KPM-së për Vlerësimin e Aplikacioneve KPM – 2014/02, Departamenti i Licencimit ka përgatitur rekomandimet për secilin rast dhe në bazë të këtyre rekomandimeve Komisioni, në takimin e mbajtur me datën 30 qershor 2016, ka marrë vendim për licencimin e 3 radio stacioneve të reja.

Komuna	Kategoria e licencës
1. Prishtinë	Regjionale – 2 frekuenca
2. Gjilan	Lokale – 1 frekuencë
3. Hani i Elezit	Nuk ka pasur kandidat të interesuar

*Tabela me emrin e komunave të Kosovës në të cilat janë licencuar radio stacionet e reja:*

## **DEPARTAMENTI LIGJOR**

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2016, ka shqyrtuar raste të ndryshme të shërbyesve medial audio-vizual për shkelje të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe akteve nënligjore të KPM-së. Departamenti Ligjor, gjatë vitit 2016, ka shqyrtuar edhe raste tjera në bazë të ankesave të personave fizik dhe juridik të parashtruara kundër të licencuarve të KPM-së.

Rastet e proceduara në bazë të shkeljes së dispozitave ligjore të Ligjit për KPM-në, dhe akteve nënligjore të KPM-së (*Shtojca II. Tabela e Rasteve Ligjore*) janë kategorizuar dhe paraqitur si në vijim:

### ***Rastet për transmetim ilegal - Shkelja e nenit 21, paragrafit 1 dhe nenit 30, paragrafit 5 të Ligjit Nr. 04/L-44 të KPM-së***

Gjatë vitit 2016, janë proceduar katër (4) raste për shkelje të nenit 21, paragrafit 1, të Ligjit për KPM-në, i cili përcakton se: “Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij Ligji kërkohet licenca për transmetim të cilin e lëshon KPM-ja”, dhe nenit 30, paragrafit 5, të Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se: “Kushdo që operon pa leje transmetimi valide, i konfiskohet aparatura përkatëse për transmetim. Subjekti i tillë transmetues nuk mund të ankohet tek Bordi për Ankesa”.

Departamenti Ligjor i KPM-së i ka dërguar Njoftim për Shkelje këtyre operatorëve të shpërndarjes për operim ilegal. Një (1) nga këta operatorë të shpërndarjes ka ardhur në pajtueshmëri duke u pajisur me licencë të KPM-së, ndërsa tre (3) të tjerë barten për vitin 2017, për procedim të mëtutjeshëm.

### ***Rastet e Shkeljes së Ligjit Nr. 04/L-44 të KPM-së, nenit 28 - Mos sjellja e Raportit Vjetor***

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2016, ka proceduar pesëdhjetenëntë (59) raste lidhur me këtë shkelje.

Pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje nga ana e Departamentit Ligjor, njëzet (20) nga këto subjekte transmetuese kanë ardhur në pajtueshmëri dhe si raste janë mbyllur. Ndërsa, për tridhjetenëntë (39) subjekte transmetuese tjera, rastet barten në vitin 2017, për procedim të mëtutjeshëm.

### ***Rastet për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-Vizuale KPM -2013/03***

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2016, ka proceduar dy (2) raste kundër shërbyesve medial audio-vizual që janë gjetur në shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-Vizuale KPM-2013/03.

Pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje, dy (2) këto subjekte transmetuese kanë ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KPM 2013/03, dhe rastet janë mbyllur.

### ***Rastet për shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM- 2013/01***

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2016, ka proceduar dy (2) raste kundër shërbyesve medial audio-vizual lidhur me shkeljen e Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM 2013/01.

Pas dërgimit të Njoftimeve për Shkelje, dy (2) këto subjekte transmetuese kanë ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/01. Rastet janë mbyllur.

### ***Rastet për shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës***

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2016, ka proceduar njëmbëdhjetë (11) raste kundër shërbyesve medial audio-vizual lidhur me shkeljen Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

Pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje, dhjetë (10) nga këto subjekte transmetuese kanë ardhur në pajtueshmëri dhe si raste ligjore janë mbyllur. Ndërsa, një (1) operator i shpërndarjes, edhe pas Njoftimit për Shkelje, ka dështuar të veprojë në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës dhe për këtë Komisioni i KPM-së ka marr Vendim, masë sanksionuese pezullim i transmetimit për tre muaj. Rasti është mbyllur.

***Rastet për shkeljen e Rregullores për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Tarifës për Licencë KPM-2014/03 - Mos pagesa e taksës për licencë***

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2016, ka proceduar nëntëdhjeteshtatë (97) raste lidhur me këtë shkelje. Departamenti Ligjor për të gjitha këto raste ka dërguar Njoftim për Shkelje. Nga këto subjekte, tridhjetekatër (34) prej tyre kanë ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2014/03. Ndërsa, gjashtëdhjetetë (63) prej tyre kanë dështuar të veprojnë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2014/03. Këto raste barten për procedim në vitin 2017 përmes përmbauesve privatë.

***Rastet për shkeljen e Rregullores për Distribuim Kabllorë të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC-2007/04***

Departamenti Ligjor, gjatë vitit 2016, ka proceduar katër (4) raste lidhur me këtë shkelje.

Pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje nga ana e Departamentit Ligjor për shkelje të nenit 18, paragrafit 3 dhe 4, të gjithë operatorët e shpërndarjes kanë ardhur në pajtueshmëri dhe rastet janë mbyllur.

***Rastet për shkeljen e Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audio Vizuale KPM-2016/01, rastet të cilat janë paraqitur pas shfuqizimit të Rregullores CIMC-2007/04 dhe janë proceduar me këtë rregullore të re***

Departamenti Ligjor, gjatë vitit 2016, ka proceduar njëzet e dy (22) raste lidhur me këtë shkelje.

Pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje nga ana e Departamentit Ligjor për shkelje, të gjithë këta operatorë të shpërndarjes kanë ardhur në pajtueshmëri dhe rastet janë mbyllur.

***Rastet e Shkeljes së Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenit 49, paragrafit 6 dhe 7, nenit 52, paragrafit 1, si dhe Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, nenit 9 paragrafit 7***

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2016, ka proceduar gjashtë (6) raste lidhur me shkeljet e lartpërmendura. Pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje nga ana e Departamentit Ligjor për shkelje, të gjithë subjektet transmetuese kanë ardhur në pajtueshmëri dhe rastet janë mbyllur.

***Rastet dhe Kërkesat tjera të proceduara nga KPM gjatë vitit 2016, Shkelja e Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale KKPM – 2010/01 dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës.***

Janë proceduar njëzet e tetë (28) raste:

- Rasti i parë është proceduar bazuar në ankesën e operatorit të shpërndarjes IPKO ndaj operatorëve të shpërndarjes që bartin platformën TRING TV, ku në ankesë thuhet se operatorët e shpërndarjes transmetojnë filma të platformës TRING TV pa të drejtë të autorit, ku IPKO pretendon se ka të drejtën e ritransmetimit për territorin e Republikës së Kosovës. KPM ka vlerësuar ankesën dhe ka kërkuar nga operatorët tjerë të sjellin kontratat për të drejtën e transmetimit të filmave, të cilat operatorët i kanë sjell kontratat duke i siguruar këto të drejtat. KPM i ka dërguar shkresë IPKO-së. Rasti është mbyllur.
- Rasti i dytë është proceduar bazuar në ankesën e operatorit të shpërndarjes IPKO ndaj operatorëve të shpërndarjes që bartin platformën TRING TV, ku në ankesë thuhet se operatorët e shpërndarjes transmetojnë filma të platformës TRING TV pa të drejta të autorit, ku IPKO pretendon se ka të drejtën e ritransmetimit për territorin e Republikës së Kosovës. KPM ka vlerësuar ankesën dhe ka kërkuar nga operatorët tjerë të sjellin kontratat për të drejtën e filmave, dhe ka gjetur se TRING TV ka siguruar të drejtën e transmetimit për filmat e cekur në ankesë. KPM i ka dërguar shkresë IPKO-së. Rasti është mbyllur.
- Rasti i tretë është proceduar bazuar në ankesën e operatorit të shpërndarjes IPKO ndaj operatorëve të shpërndarjes si në vijim: KUJTESA NET, EAGLE, ELEKTRA, SPEED TV, KUMANOVA, DRINIA NET, EGC, GALAKTIKA, ALBI NET, CONNECT ISP, ORANGE NET, BLEDI, ISP BROADCAST, HIGH SPEED, KOSOVA NET, ART MOTION, ASTRA NET, DIONI NET, MAX TV, ARDI,J@B NET, KLINET, MIRANDA NET dhe KADRIA NET, ku në ankesë thuhet se operatorët e shpërndarjes transmetojnë filma pa të drejta të autorit, ku IPKO pretendon se ka të drejtën e ritransmetimit për territorin e Republikës së Kosovës. KPM ka kërkuar nga të gjitha këta operatorë të sjellin dëshmi se kanë të drejtat e ritransmetimit të filmave, ku të gjithë janë përgjigjur kërkesës dhe kanë sjellë kontratat. KPM i ka dërguar shkresë IPKO-së. Rasti është mbyllur.
- Rasti i katërt është proceduar bazuar në ankesën e operatorit të shpërndarjes IPKO ndaj operatorëve të shpërndarjes që bartin platformën TRING TV, ku në ankesë thuhet se operatorët e shpërndarjes transmetojnë filma të platformës TRING TV pa të drejtë të autorit, ku IPKO pretendon se ka të drejtën e ritransmetimit për territorin e Republikës së Kosovës. KPM ka vlerësuar ankesën dhe ka kërkuar nga operatorët tjerë të sjellin kontratat për të drejtë të transmetimit të filmave, dhe ka gjetur se TRING TV me kompanitë të cilat ka bërë marrëveshje i kanë siguruar të drejtat për transmetim të filmave të cekur në ankesë. KPM i ka dërguar shkresë IPKO-së. Rasti është mbyllur.

- Rasti i pestë është proceduar bazuar në ankesën e operatorit të shpërndarjes IPKO ndaj operatorëve të shpërndarjes që bartin platformën TRING TV, ku në ankesë thuhet se operatorët e shpërndarjes të cilët i kanë deponuar kontratat për bartjen e platformës TRING TV, nuk janë në rregull. KPM edhe njëherë e ka njoftuar IPKO-n se kontratat të cilat janë deponuar nga ana e operatorëve të shpërndarjes janë vlerësuar dhe se janë valide dhe për këtë ankesa është cilësuar si e pabazuar. KPM i ka dërguar shkresë IPKO-së. Rasti është mbyllur.
- Rasti i gjashtë është proceduar bazuar në ankesën e TRING TV ndaj operatorit të shpërndarjes IPKO, ku në ankesë thuhet se operatori i shpërndarjes IPKO ka transmetuar përmbajtje programore (filma) pa të drejtë të autorit, ku TRING TV pretendon se ka të drejtën e ritransmetimit. KPM ka vlerësuar ankesën dhe ka kërkuar nga IPKO të sjell kontratat për të drejtën e transmetimit të filmave, dhe ka gjetur se IPKO nuk i ka transmetuar fare filmat e cekur në ankesë. KPM i ka dërguar shkresë TRING TV. Rasti është mbyllur.
- Rasti i shtatë është proceduar bazuar në ankesën e KUJTESA NET ndaj operatorit të shpërndarjes IPKO, ku në ankesë thuhet se operatori i shpërndarjes IPKO ka transmetuar përmbajtje programore (ngjarje sportive) pa të drejtë të autorit. KPM ka vlerësuar ankesën dhe ka kërkuar nga IPKO të sjell kontratat për të drejtën e transmetimit të ngjarjeve sportive, dhe ka gjetur se IPKO ka transmetuar ngjarje sportive pa të drejtë të autorit. KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje IPKO-së. Gjithashtu, përgjigje i është dërguar edhe KUJTESA NET për veprimet ligjore që janë ndërmarr ndaj IPKO-së. Rasti është mbyllur.
- Rasti i tetë është proceduar bazuar në ankesën e operatorit të shpërndarjes IPKO ndaj operatorëve të shpërndarjes që bartin kanale të TRING TV, ku në ankesë thuhet se operatorët e shpërndarjes transmetojnë filma të platformës TRING TV pa të drejtë të autorit, ku IPKO pretendon se ka të drejtën e ritransmetimit për territorin e Republikës së Kosovës. KPM ka vlerësuar ankesën dhe ka kërkuar nga operatorët tjerë të sjellin kontratat për të drejtën e transmetimit të filmave, dhe ka gjetur se TRING TV me kompaninë UNISON GROUP, ka bërë marrëveshje duke i siguruar të drejtat e transmetimit për filmat e cekur në ankesë. KPM i ka dërguar shkresë IPKO-së. Rasti është mbyllur.
- Rasti i nëntë është proceduar bazuar në ankesën e IPKO ndaj operatorit të shpërndarjes EAGLE, ku në ankesë thuhet se operatori i shpërndarjes EAGLE ka transmetuar përmbajtje programore (ngjarje sportive) pa të drejtë të autorit. KPM ka vlerësuar ankesën dhe ka kërkuar nga EAGLE të sjell kontratat për të drejtën e transmetimit të ngjarjeve sportive, mirëpo EAGLE ka dështuar t'i sjell ato brenda afatit ligjor të kërkuar dhe për këtë, KPM ka gjetur se EAGLE ka vepruar në kundërshtim me nenin 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të KPM-së, duke ritransmetuar ngjarje sportive pa të drejtë të autorit. Lidhur me këtë, KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje EAGLE. Rasti është mbyllur.
- Rasti i dhjetë është proceduar bazuar në ankesën e IPKO ndaj operatorit të shpërndarjes ELEKTRA, ku në ankesë thuhet se operatori i shpërndarjes ELEKTRA transmeton përmbajtje

ilegale të kanaleve të DIGITALB duke përfshirë edhe kanalet e sportit pa të drejtë të autorit. KPM ka vlerësuar ankesën dhe ka gjetur se ELEKTRA nuk i ka ri-transmetuar kanalet e DIGITALB. KPM i ka dërguar shkresë IPKO-së. Rasti është mbyllur.

- Rasti i njëmbëdhjetë është proceduar bazuar në ankesën e IPKO-së ndaj operatorit të shpërndarjes ART MOTION, ku në ankesë thuhet se operatori i shpërndarjes ART MOTION ri-transmeton kanale pa të drejtë autoriale për të cilat IPKO pretendon se e ka të drejtën ekskluzive. KPM ka vlerësuar ankesën dhe ka gjetur se ART MOTION i posedon të drejtat e autorit për ri-transmetimin kanaleve të cekura në ankesën e IPKO-së. KPM i ka dërguar shkresë IPKO-së. Rasti është mbyllur.
- Rasti i dymbëdhjetë është proceduar bazuar në ankesën e IPKO-së ndaj operatorëve të shpërndarjes NEGE NET, ELEKTRA, ASRTA NET, KADRIA NET, J@B NET, EAGLE dhe GALAKTIKA, ku në ankesë thuhet se operatorët e shpërndarjes kanë ri-transmetuar përmbajtje programore të platformës DIGITALB, kanale pa të drejtë autoriale. KPM ka vlerësuar ankesën dhe ka gjetur se operatorët e shpërndarjes të lartcekur nuk kanë ri-transmetuar përmbajtjen programore të platformës DIGITALB ashtu siç thuhet në ankesë dhe për këtë, Komisioni i KPM-së ka marrë Vendim që ankesa e IPKO-së e parashtuar ndaj operatorëve të shpërndarjes të refuzohet si e papabuar. KPM i ka dërguar Vendimin IPKO-së. Rasti është mbyllur.
- Rasti i trembëdhjetë është proceduar bazuar në ankesën e IPKO-së ndaj 32 operatorëve të shpërndarjes, ku në ankesë thuhet se operatorët e shpërndarjes kanë ri-transmetuar përmbajtje programore të platformës DIGITALB, kanale pa të drejtë autoriale. KPM ka vlerësuar ankesën dhe ka gjetur se operatorët e shpërndarjes nuk kanë ri-transmetuar përmbajtjen programore të platformës DIGITALB ashtu siç thuhet në ankesë. KPM i ka dërguar shkresë IPKO-së. Rasti është mbyllur.
- Rasti i katërbëdhjetë është proceduar bazuar në ankesën e IPKO-së ndaj operatorit të shpërndarjes ART MOTION, ku në ankesë thuhet se operatori i shpërndarjes ART MOTION ka ri-transmetuar ngjarje sportive pa të drejtë autoriale. KPM ka vlerësuar ankesën dhe ka gjetur se ART MOTION ka vepruar në kundërshtim me nenin 5, paragrafin 1 të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audio Vizuale KPM 2016/01, dhe për këtë KPM i ka dërguar ART MOTION Njoftim për Shkelje. Rasti është mbyllur.
- Rasti i pesëmbëdhjetë është proceduar bazuar në ankesën e KUJTESA NET ndaj operatorit të shpërndarjes KADRIA NET, ku në ankesë thuhet se operatori i shpërndarjes KADRIA NET ka ri-transmetuar ngjarje sportive pa të drejtë autoriale. KPM ka vlerësuar ankesën dhe ka gjetur se KADRIA NET ka vepruar në kundërshtim me nenin 5, paragrafin 1 të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audio Vizuale KPM 2016/01, dhe për këtë KPM i ka dërguar KADRIA NET Njoftim për Shkelje. Rasti është mbyllur.

- Rasti i gjashtëmbëdhjetë është proceduar bazuar në ankesën e IPKO ndaj operatorit të shpërndarjes KUJTESA NET, ku në ankesë thuhet se operatori i shpërndarjes KUJTESA NET ka ri-transmetuar ngjarje sportive pa të drejtë autoriale. KPM ka vlerësuar ankesën dhe ka gjetur se KUJTESA NET ka vepruar në kundërshtim me nenin 5, paragrafin 1 të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audio Vizuale KPM 2016/01, dhe për këtë KPM i ka dërguar KUJTESA NET Njoftim për Shkelje. Rasti është mbyllur.
- Rasti i shtatëmbëdhjetë është proceduar bazuar në ankesën e z. Arsim Bajrami, përfaqësues i fshatit Gërdoc, të parashtruar ndaj subjektit transmetues publik RTK1 për shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale KKPM-2010/01. Ankesa i referohet kronikës së transmetuar në edicionin e lajmeve në RTK 1, ndaj të cilës pala ankuese pretendon se është vënë në pikëpyetje integriteti territorial i fshatit Gërdoc. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e RTK 1 dhe ka gjetur se RTK 1 ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale KKPM-2010/01 dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje RTK 1. Rasti është mbyllur.
- Rasti i tetëmbëdhjetë është proceduar bazuar në ankesën e z. Arsim Bajrami, përfaqësues i fshatit Gërdoc, të parashtruar ndaj subjektit transmetues KTV për shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale audio-vizuale KKPM-2010/01. Ankesa i referohet kronikës së transmetuar në edicionin e lajmeve në KTV, ndaj të cilës pala ankuese pretendon se është vënë në pikëpyetje integriteti territorial i fshatit Gërdoc. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e KTV dhe ka gjetur se KTV ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale KKPM-2010/01 dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje KTV-së. Rasti është mbyllur.
- Rasti i nëntëmbëdhjetë është proceduar bazuar në ankesën e z. Agron Demi të parashtruar ndaj subjektit transmetues publik RTK 1 për shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale audio-vizuale KKPM-2010/01. Ankesa i referohet kronikës së transmetuar në edicionin qendror të lajmeve në RTK 1, ndaj të cilës pala ankuese pretendon se është përfshirë në kronikën e transmetuar pa marr qëndrimin personal duke ia shtrembëruar një deklaratë të postuar në rrjetin social facebook. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e RTK 1 dhe ka gjetur se RTK 1 ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale KKPM-2010/01, dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje RTK 1. Komisioni i KPM-së ka marr Vendim ndaj RTK 1, masë sanksionuese Vërejtje, ndërsa ndaj këtij Vendimi RTK 1 ka bërë ankesë në Bordin e Ankesave të KPM-së. Rasti bartet për vitin 2017.
- Rasti i njëzet është proceduar bazuar në ankesën e z. Vedat Llonqari të parashtruar ndaj subjektit transmetues TV DUKAGJINI për shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale KKPM-2010/01. Ankesa i referohet një interviste të transmetuar në emisionin InfoBox në TV DUKAGJINI ku i ftuar ka qenë z. Ramiz Kelmendi, ndaj të cilës pala ankuese pretendon se është përfshirë emri i tij në fund të intervistës lidhur më një vendim të inspektoratit të punës ku është konstatuar shkelja e rëndë ligjore që kompania ELKOS ka bërë ndaj z.



Llonqari. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e TV DUKAGJINI dhe ka gjetur se TV DUKAGJINI ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale KKPM-2010/01 dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje TV DUKAGJINI. Rasti është mbyllur.

- Rasti i njëzet e një është proceduar bazuar në ankesën e z. Arben Visoqi të parashtruar ndaj subjektit transmetues TV DUKAGJINI për shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03. Ankesa i referohet emisionit Zyra e Ankesave të transmetuar në TV DUKAGJINI, ndaj të cilës pala ankuese pretendon se gazetari z. Arben Ahmeti ka bërë fyerje të veteranëve të luftës dhe fëmijëve të dëshmorëve të UÇK-së. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e TV DUKAGJINI dhe ka gjetur se TV DUKAGJINI nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03, dhe për këtë KPM i ka dërguar shkresë z. Visoqi. Komisioni i KPM-së ka marr Vendim ndaj z. Arben Visoqi, duke ia refuzuar ankesën si të pabazuar. z.Visoqi ka bërë ankesë në Bordin e Ankesave të KPM-së. Rasti bartet për vitin 2017.
- Rasti i njëzet e dy është proceduar bazuar në ankesën e z. Veton Berisha të parashtruar ndaj ofruesit e shërbimeve programore Klan Kosova për shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03. Ankesa i referohet emisionit NIN të transmetuar në Klan Kosova, ndaj të cilës pala ankuese pretendon se gazetari z. Alaudin Hamiti ka bërë fyerje dhe diskriminim të komunitetit RAE. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e Klan Kosova dhe ka gjetur se Klan Kosova nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03. Rasti është mbyllur.
- Rasti i njëzet e tre është proceduar bazuar në ankesën e z. Sami Bilalli të parashtruar ndaj subjektit transmetues KTV për shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale KKPM-2010/01. Ankesa i referohet një kronike të transmetuar në edicionin e lajmeve qendrore në KTV, në të cilën kronikë është përfshirë z. Bilalli pa marr qëndrimin personal duke cenuar integritetin personal duke bërë fyerje dhe njollosje të familjes Bilalli. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e KTV dhe ka gjetur se KTV ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03 dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje KTV. Rasti është mbyllur.
- Rasti i njëzet e katër është proceduar bazuar në ankesën e z. Avni Dehari të parashtruar ndaj ofruesit të shërbimeve programore Klan Kosova për shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03. Ankesa i referohet emisionit Zona e Debatit, përkatësisht gazetarit z. Baton Haxhiu, ndaj të cilës pala ankuese pretendon se gazetari z.Baton Haxhiu ka bërë transmetimin e pamjeve pa autorizim nga kamerat e sigurisë së Qendrës së Paraburgimit në Prizren, duke pretenduar se këto pamje kanë qenë fyese dhe denigruese për familjen Dehari. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e Klan Kosova dhe ka gjetur se Klan Kosova nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e

Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03 ashtu siç pretendohet në ankesën e palës ankuese. .

- Rasti i njëzet e pesë është proceduar bazuar në ankesën e Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut Kosovë, përfaqësuar nga znj. Teuta Hoxha, të parashtruar ndaj ofruesit të shërbimeve programore KLAN KOSOVA për shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale KKPM-2010/01. Ankesa i referohet emisionit Ëazzup të transmetuar në KLAN KOSOVA, ndaj të cilës pala ankuese pretendon se gazetarja gjatë transmetimit të emisionit ka përdorur shprehje fyese dhe denigruese për komunitetin serb në Kosovë. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e KLAN KOSOVA dhe ka gjetur se KLAN KOSOVA nuk ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale audio-vizuale KKPM-2010/01. KPM i ka dërguar përgjigje znj. Hoxha. Rasti është mbyllur.
- Rasti i njëzet e gjashtë është proceduar bazuar në ankesën e Grupit Koha, të parashtruar ndaj KPM-së për mos zbatim të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audio Vizuale KPM-2016/01. Pala ankuese pretendon se KPM që nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje nuk ka ndërmarr asnjë veprim ndaj operatorëve të shpërndarjes të cilët nuk janë duke e respektuar këtë Rregullore. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës iu është përgjigjur Palës Ankuese me shkresë duke ia sqaruar veprimet ligjore që KPM i ka ndërmarr ndaj operatorëve të shpërndarjes të cilët nuk e kanë zbatuar Rregulloren KPM-/2016/01. Rasti është mbyllur.
- Rasti i njëzet e shtatë është proceduar bazuar në ankesën e AMPEK të parashtruar ndaj KPM-së për mos zbatim të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audio Vizuale KPM-2016/01. Pala ankuese pretendon se KPM që nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje nuk ka ndërmarr asnjë veprim ndaj operatorëve të shpërndarjes të cilët nuk janë duke e respektuar këtë Rregullore. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës iu është përgjigjur Palës Ankuese me shkresë duke ia sqaruar veprimet ligjore që KPM i ka ndërmarr ndaj operatorëve të shpërndarjes të cilët nuk e kanë zbatuar Rregulloren KPM-/2016/01. Rasti është mbyllur.
- Rasti i njëzet e tetë është proceduar bazuar në ankesën e z. Berat Preniqi të parashtruar ndaj subjektit transmetues RADIO KOSOVA 1, për shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale KKPM-2010/01. Ankesa i referohet emisionit Metropol ku, ku sipas palës ankuese, përgjatë emisionit bëhet thirrje seksiste, shprehje eksplicite, pornografike, vulgare dhe amorale. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e RADIO KOSOVA 1 dhe ka gjetur se RADIO KOSOVA 1 nuk ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale KKPM-2010/01. Rasti është mbyllur.

## DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR

### *Analiza e Spektrit Frekuencor – Transmetimet analoge*

Gjatë vitit 2016, janë monitoruar radio televizionet nacionale, regjionale e lokale me qëllim të verifikimit të pajtueshmërisë së zonës së mbulimit me pjesën e dytë dhe të katërt të Licencës. Gjithashtu, janë monitoruar edhe radio frekuencat që i shfrytëzojnë KFOR-i, UNMIK-u dhe radio stacionet e huaja ndërkombëtare për nevojat e tyre. Të dhënat nga kontrollet dhe matjet dëshmojnë se shfrytëzimi i spektrit frekuencor në territorin e Kosovës vazhdon të mbetet përafërsisht i njëjtë në krahasim me situatën në vitin 2015, me përjashtim të numrit të madh të sinjaleve radio dhe TV që vijnë nga vendet fqinje (Serbia, Maqedonia dhe Shqipëria).

### *Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21)*

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra, vërtetohet se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV të subjekteve transmetuese nacionale është e një kualiteti shumë të mirë (65 dBuV/m për TV) dhe e pa ndërferuar për ato lokacione që i mbulojnë, dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me Pjesën e Dytë e të Katërt të Licencës. Megjithatë, duhet të theksohet se nga raportet e mëhershme, mbulimi i tërësishëm i territorit të Kosovës nuk është i kënaqshëm. Aktualisht, territori i Republikës së Kosovës mbulohet vetëm me **62,7%** me sinjal televiziv. Regjione të tëra si: Dragashi, Kaçaniku, Zhupa, Kamenica, Klina, Artana, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi kanë mbetur në tërësi apo pjesërisht jashtë zonës së mbulimit me sinjal televiziv për shkak të problemit të vazhdueshëm të mos aktivizimit të pikës së lartë të Goleshit, për transmetim primar televiziv si dhe mos aktivizimit të rrjetit sekondar (rrjeti i përsëritësve televiziv). Në këtë kontekst KPM-ja në vazhdimësi ka informuar organet më të larta shtetërore të Republikës së Kosovës, për rëndësinë e aktivizimit të kësaj pike për transmetim televiziv.

Pika e lartë e Goleshit përdoret vetëm nga KFOR-i për transmetime radio FM. Për të siguruar mbulueshmëri më të gjerë me sinjal televiziv është shumë e rëndësishme që kjo pikë të aktivizohet edhe për subjektet transmetuese televizive.

Maja e Goleshit është e regjistruar në ITU, respektivisht në të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare që nga Stokholm 61, Gjeneva 84, 89 dhe e fundit Gjeneva 2006, si pikë kryesore e transmetimit për Kosovën. Për këtë arsye janë të rezervuara dhe të pranuar ndërkombëtarisht kanale transmetimi radio e televizive me fuqi të mëdha rrezatimi. Me aktivizimin e kësaj pike të lartë të Goleshit për transmetim televiziv, do të rritej zona e mbulimit nga 62.7% (me nivel të sinjalit të kënaqshëm prej 60 dBuV/m) në 80% të territorit të Kosovës dhe do të mundësohej zhvillimi i rrjetit sekondar, ashtu që të arrihet që mbi 90% e territorit të Kosovës të mbulohet me sinjal televiziv kualitativ.

### ***Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini)***

Gjatë vitit 2016, Departamenti për Menaxhim Frekuencor (DMF) ka bërë matjet në kuadër të përcaktimit të objektivave të KPM-së për vitin 2015, të cilat kanë pasur për qëllim sigurimin e mbulueshmërisë së zonave të veçanta gjeografike të territorit të Republikës së Kosovës (me theks të veçantë rrugët magjistrale dhe regjionale), me sinjal kualitativ të të licencuarve, me mbulim nacional në radio në brezin frekuencor VHF/FM (87.5 - 108 Mhz).

DMF-ja, gjatë matjeve të bëra në terren ka vërtetuar gjendjen e njëjtë si dhe gjatë vitit paraprak që tregon se në disa zona të caktuara, Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini nuk ofrojnë mbulim të mirë, ndërsa niveli i sinjalit të mbulueshmërisë është nën nivelin e duhur të 54 dBuV/m. Matjet teknike janë bërë në disa rrugë magjistrale si: Prishtinë-Gjilan (Slivovë, Llabjan, Parillovë dhe Bresalc); Kaçanik – Hani i Elezit; Mitrovicë – Bajgorë; Shtime – Carralevë, Dragash – Restelicë; Prizren – Brezovicë; Kramovik – Dollc; Pejë – Rugovë; Kamenicë, dhe është vërejtur se në këto zona nuk ka fare pranim të sinjalit të radiove nacionale.

Në bazë të këtyre rezultateve, KPM konstaton se Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini nuk janë duke transmetuar në pajtim me parametrat teknikë siç janë të përcaktuara me Pjesën 2 të licencës së KPM-së.

KPM është e gatshme që të sigurojë frekuenca shtesë me qëllim të mbulimit të zonave ku nuk ka fare sinjal, ndërsa, në bashkëpunim me ta edhe të gjej lokacionet e përshtatshme për pika të transmetimit.

### ***Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regjional dhe lokal***

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra vërtetohet se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV dhe radio të subjekteve transmetuese është e një kualiteti shumë të mirë (60 dBuV/m për TV dhe 54 dBuV/m për FM radio transmetime) dhe e përndërfaqur për ato lokacione që i mbulojnë dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me Pjesën e dytë dhe të katërt të licencës. Televizionet regjionale – lokale mbulojnë rreth **68.14%** të territorit të Kosovës me sinjal televiziv ndërsa, radiot lokale/regjionale mbulojnë rreth **96.98%** të territorit të Kosovës.

### ***Rastet për interferencë***

Gjatë vitit 2016 DMF, ka pranuar pesë (5) ankesa për interferencë nga subjektet transmetuese Radio Plus ( Prishtinë), Radio Vala Rinore (Prishtinë), Radio Malisheva (Malishevë) dhe Radio Star (Gjilan).

1. Në Raportin e monitorimit lidhur me ankesën e Radio Plus, sipas të cilës është i ndërfaqur nga Radio 21, pas matjeve në terren është konstatuar se nuk ka ndonjë ndërfaqë në frekuencën e Radio Plusit.

2. Në Raportin e monitorimit lidhur me ankesën e Radio Vala Rinore për interferencë nga Radio 21, pas matjeve në terren është konstatuar se radio Vala Rinore është duke i shkaktuar probleme vetvetes. Pas gjetjeve në terren është bërë evitimi i “interferencës”.
3. Raporti i monitorimit lidhur me ankesën e Radio Malisheva për interferencë nga Radio Drenasi rezulton se nuk ka pasur interferencë në frekuencën e subjektit transmetues.
4. Nga monitorimi lidhur me ankesën e Radio Star për interferencë nga Radio Viktoria, rezulton se nuk ka pasur interferencë në frekuencën e subjektit transmetues.
5. Nga monitorimi lidhur me ankesën e Radio Star për interferencë nga Radio Gjilani, rezulton se nuk ka pasur interferencë në frekuencën e subjektit transmetues.

### ***Rastet për transmetime të palicencuara***

DMF gjatë vitit 2016, nuk ka proceduar me asnjë rast ilegalë të ndonjë radioje apo televizioni me frekuencë tokësore në territorin e Republikës së Kosovës.

### ***Frekuencat e revokuara nga KPM***

DMF gjatë vitit 2016 nuk ka proceduar me asnjë rast për të cilën është dashur të revokohet ndonjë frekuencë (licencë).

### ***Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me KFOR***

DMF gjatë vitit 2016 ka bërë edhe monitorime të frekuencave radio që janë në shfrytëzim të KFOR-it, UNMIK-ut dhe radiostacioneve të huaja ndërkombëtare, me qëllim të azhurnimit të bazës së të dhënave që posedon KPM-ja. Gjatë vitit 2016, radiot e huaja ndërkombëtare BBC, VOA dhe RFI vazhdojnë transmetimet e tyre.

Frekuencat për transmetime radio FM që i përdor KFOR-i, UNMIK-u dhe radiostacionet e huaja ndërkombëtare, nuk i janë nënshtruar procesit të licencimit afatgjatë, dhe si të tilla mund të paraqesin interferencë në të ardhmen për shkak të mos instalimit të filtrave dalës. Po ashtu gjatë vitit 2016, ka vazhdon bashkëpunimi i KPM-së me KFOR-in për të siguruar pikën e lartë të Goleshit si zonë transmetuese e lirë dhe opsionet për të arritur këtë mbesin të trajtohen përmes marrëveshjeve të mirëkuptimit në mes institucioneve relevante kosovare dhe KFOR-it

### ***Kërkesa për ndryshim të lokacionit të transmetimit***

Gjatë vitit 2016 DMF ka proceduar me këto kërkesa të subjekteve transmetuese të licencuara për ndërrim të lokacionit të transmetimit:

- Radio Kent FM - kërkesë për ndryshimin e lokacionit të transmetimit, i cili ka plotësuar kushtet për ndryshim të lokacionit;

- Radio Dukagjini - kërkesë për ndryshimin e lokacioneve për të gjitha pikat e transmetimit (për transmetim nacional. Për shkak të distancave të vogla të transmetimit i është aprovuar kërkesa për ndryshim.

### ***Raste të ndryshimit të lokacionit të transmetuesit pa miratim të KPM-së***

Gjatë vitit 2016 DMF, nuk ka proceduar me ndonjë rast të subjekteve transmetuese të cilat kanë bërë ndryshimin e pikës së transmetimit pa miratimin e KPM-së.

### ***Ndryshimet në parametrat teknike dhe evidentimi i frekuencave të lira për licencime të reja të shërbimeve mediale audio (radio)***

Gjatë vitit 2016 DMF ka proceduar edhe me një kërkesë për rritje të fuqisë nga Radio Alba (Istog), brenda parametrave teknik të Pjesës së katërt të Licencës, dhe kjo kërkesë është aprovuar.

DMF ka bërë edhe matje në tërë territorin e Republikës së Kosovës lidhur me gjetjen e frekuencave të lira Radio FM. Nga matjet, frekuenca të lira janë gjetur: dy frekuenca në Prishtinë (regjionale), dhe një frekuencë në Gjilan (lokale).

### ***Plani frekuencor dhe dixhitalizimi***

Gjatë vitit 2016, DMF ka bërë matje në terren lidhur me verifikimin e kanaleve të cilat janë ndarë nga ITU për transmetim dixhital në territorin e Republikës së Kosovës. Nga këto matje është konstatuar se këto kanale nuk janë të interferuara nga vendet fqinjë. Po ashtu, DMF ka bërë matje dhe lidhur me gjetjen e një kanali të lirë për transmetim Dixhital për transmetuesin Publik RTK, ku ligji për dixhitalizim e obligon KPM-në për gjetjen e këtij kanali. Nga matjet janë propozuar kanalet ch7 dhe ch67, ku nga të gjitha kanalet e ndara nga ITU, vetëm këto dy kanale janë të lira.

## **DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE**

### ***Buxheti***

Komisioni i Pavarur i Mediave është organizatë buxhetore e financuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Gjatë vitit 2016 janë bërë ndryshime lidhur me Buxhetin fillestar në raport me Buxhetin final.

Buxheti fillestar paraqet buxhetin e aprovuar sipas Ligjit për ndarjet buxhetore, të ndarë sipas kategorive ekonomike. Në kolonën e buxhetit final paraqiten shumat që janë në përputhje me Ligjin Nr.05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Buxheti final paraqet shumat që janë në përputhje me Vendimin nr. 01/123 në muajin Dhjetor 2016, të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, vendim ky që ka të bëjë me Kursimin e Shpenzimeve nga Organizatat Buxhetore në të gjitha kategoritë ekonomike. Shkurtimet buxhetore në të gjitha kategoritë ekonomike kanë vlerën prej 51,480.20 euro.

Për periudhën janar dhjetor 2016, Komisioni i Pavarur i Mediave ka shpenzuar buxhetin në vlerë prej 992,513.28 euro apo 99.75 %.

Buxheti i Komisionit të Pavarur i Mediave për vitin 2016				
Kategoritë	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i pashpenzuar
Pagat dhe mëditjet	388,292.00	343,425.18	343,425.18	0.00
Mallra dhe Shërbime	347,984.00	341,927.55	339,751.51	2,176.04
Shërbime Komunale	17,000.00	17,000.00	16,692.52	307.48
Gjithsejt Projekt.Kapit.		292,644.07	292,644.07	0.00
Arkiva Elektronike	293,201.00	292,644.07	292,644.07	0.00
<b>Total:</b>	<b>1,046,477.00</b>	<b>994,996.80</b>	<b>992,513.28</b>	<b>2,483.52</b>

Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, buxheti fillestar në vlerë prej 388,292.00 euro në krahasim me buxhetin final është zvogëluar në vlerë prej 343,425.18 euro. Ky zvogëlim është bërë në muajin dhjetor të vitit 2016, me Vendimin nr.01/123 të Qeverisë , me ç`rast kemi pasur kursime buxhetore në vlerë prej 44,866.82 euro.

Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve buxheti fillestar në vlerë prej 347,984.00 euro në krahasim me buxhetin final është zvogëluar në vlerë prej 341,927.55 euro. Në muajin Dhjetor 2016, me vendim të Qeverisë me nr.01/123 kemi kursime buxhetore në vlerë prej 6,056.45 euro.

Në kategorinë e projekteve kapitale buxheti fillestar në vlerë prej 293,201.00 euro në krahasim me buxhetin final është zvogëluar në vlerë prej 292,644.07 euro. Ky zvogëlim është bërë në muajin Dhjetor 2016, me Vendim të Qeverisë me nr.01/123, ku kemi pasur kursime buxhetore në vlerë prej 556.93 euro. Projekti i aprovuar tre vjeçar 2014-2016 “Arkiva Elektronike” ka përfunduar në periudhën janar - mars 2016.

KPM, gjatë vitit 2016, në mungesë të ndarjeve buxhetore, vazhdimisht ka kërkuar mjete shtesë, për të qenë funksional dhe për të kryer obligimet dhe detyrat që na janë dhënë me ligj, në mënyrë që të mos barten obligimet prej viti në vit.

Në mungesë të mjeteve, vitin 2017 do t`a fillojmë me obligimet kontraktuale të papaguara të vitit 2016 në kategorin e mallrave dhe shërbimeve dhe në kategorin e shërbimeve komunale. Obligimet e bartura nga viti paraprak janë në vlerë prej 10,117.65 euro dhe do të mbulohen nga buxheti i aprovuar për vitin 2017.

Nga të hyrat vetanake të mbledhura prej KPM-së janë gjeneruar 282,102.54 euro, prej tyre 272,818.36 euro u takojnë të hyrave nga licenca ndërsa shuma prej 1,244.18 euro u takojnë të hyrave nga dënimet për vonesën e pagesës së taksës dhe shuma prej 8,040.00 euro u takojnë të hyrave nga gjoba. Mjetet nga të hyrat shkojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Problemi tjetër qëndron edhe te Pasuritë kontigjente (borxhet e viteve paraprake 2011,2012, 2013) në vlerë prej 205,137.16 euro, për të licencuarit të cilët deri tani nuk e kanë kryer pagesën e tarifës për Licencë dhe gjobave. KPM këto raste i ka proceduar në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe ende nuk janë zgjidhur.

Gjithashtu, kemi probleme edhe te të Arkëtueshmet - Shërbimet audio-vizuale që nuk e kanë kryer obligimin e pagesës së tarifës për licencë për periudhën janar-dhjetor 2016, si dhe pagesën e tarifës për vitet 2015 dhe 2014. Edhe përkundër dërgimit të faturave, Njoftimit për Shkelje, këta të licencuar kanë dështuar të kryejnë obligimet për pagesën e tarifës për licencë. Këto raste nuk janë të proceduara në Gjykatë pasi që KPM është duke shqyrtuar mundësit në procedimin e këtyre rasteve te përmbaruesi privat për ekzekutim. (Në formën tabelare janë të paraqitura në PVF).



Po ashtu KPM gjatë mbledhjeve të mbajtura gjatë vitit 2015, ka marrë vendime sanksionuese për të licencuarit që janë gjetur në shkelje të Ligjit të KPM-së dhe kushteve të licencës. Lidhur me këtë Komisioni ka marr vendime për gjopa ndaj këtyre të licencuarve.

Në Shtojcën IIIa dhe IIIb është dhënë Raporti Vjetor Financiar sipas kërkesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Financave.

## **PUNA E BORDIT PËR ANKESA (BA)**

Bordi për Ankesa (BA) është organ i pavarur në bazë të nenit 36 të Ligjit për KPM-në. Bordi i Ankesave shqyrton ankesat e palëve që drejtpërdrejt kanë të bëjnë me Vendimet e Komisionit të KPM-së. Bordi për Ankesa përbëhet prej tre (3) anëtarëve të cilët emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Nga radhët e anëtarëve të Bordit për Ankesa, Kuvendi zgjedh Kryetarin. Anëtarët e Bordit për Ankesa emërohen me mandat tre (3) vjeçar.

### *Seancat dhe Vendimet e Bordit për Ankesa*

Bordi për Ankesa (BA) gjatë vitit 2016, ka mbajtur vetëm një seancë konsultative pasi që përgjatë tërë vitit, BA ka pasur vetëm dy anëtarë z. Avdyl HYSENI- Kryetar dhe z. Musa DRAGUSHA-anëtar i Bordit për Ankesa, të cilët janë emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në seancën e mbajtur më 16 qershor 2016.

## OBJEKTIVAT E VITIT 2016:

KPM ka vazhduar punën me intensitet të shtuar në përmbushjen e objektivave të parapara për vitin 2016 rreth implementimit të procesit të dixhitalizimit duke amandamentuar dhe hartuar legjislacionin sekondar sipas obligimeve ligjore dhe duke u bazuar në përvojat e vendeve fqinje dhe atyre të BE-së.

Politikat e KPM-së janë të tilla që krijojnë mundësi në diversitet dhe pluralizëm medial, që i shërbejnë gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. KPM, në vitin 2016, ka lëshuar licenca të reja për shërbime mediale audio me frekuenca lokale në mënyrë që të ofrohet qasje në informim qytetarëve, në zonat ku ka pasur mungesë të këtyre shërbimeve. KPM ka krijuar bazën ligjore edhe për zhvillimin e ofertave të reja përmes platformave të reja si: IPTV, OTT dhe të tjera si dhe zhvillimi i ofertave të reja programore përmes platformave të operatorëve të shpërndarjes.

## OBJEKTIVAT E PARAPARA PËR VITIN 2017

- Përcjellja e procesit të Dixhitalizimit në tërë kompleksitetin e vet;
- Zhvillimi i pluralizmit medial që u shërben gjithë qytetarëve të Kosovës;
- Mbulueshmëria e zonave të veçanta gjeografike të territorit të Republikës së Kosovës (rrugëve magjistrale dhe regjionale) me sinjal kualitativ të programeve të radio programeve me mbulueshmëri nacionale;
- Binjakëzimi me rregullatorët e vendeve tjera me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe;
- Avancimi i bashkëpunimit me Autoritetet Rregullative Evropiane.

## ***REKOMANDIMET/SFIDAT E INSTITUCIONIT (PROBLEMET ME BUXHETIN, RITJA E STAFIT,)***

### ***Problemet me buxhetin***

Shkurtime buxhetore që KPM ka pasur vazhdimisht, po pamundësojnë funksionimin tonë si një institucion i pavarur dhe po rrezikon përmbushjen e objektivave të parapara për vitet e ardhshme.

### ***Nevoja për punëtorë të rinj***

Për disa vjet radhazi, KPM kërkon shtimin e stafit, duke u bazuar në kërkesat reale që ndërlidhen me zgjerimin e fushëveprimit të KPM-së, marrë parasysh edhe faktin se numri i të licencuarve nga KPM është rritur dukshëm dhe se shtimi i volumit të detyrave për nëpunësit ekzistues është trefishuar. KPM-ja ka paraqit kërkesa në vazhdimësi dhe ende nuk është aprovuar kjo rritje e numrit të punëtorëve. Aktualisht jemi duke u ballafaquar me mungesë të theksuar të stafit dhe si rezultat i kësaj në vazhdimësi ka ngarkesa në punë, të cilat po rezultojnë edhe me pamundësinë e kryerjes së detyrave sipas pritjeve. Kjo gjendje gjithsesi mund të ketë edhe efekte negative sa i përket zbatimit të rregulloreve dhe procedurave në punë. Mungesa e stafit do të vështirësoj edhe punën e KPM-së në zbatimin e ligjit të KPM-së dhe atij për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore

## AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2015

*Plani i Veprimit të Menaxhmentit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit të ZAP-it*

Nr	Rekomandimi ose gjetja	Veprimi i ndërmarrë ose propozuar	Afati i zbatimit	Vlerësimi i rrezikut
1.	<p><b>Rekomandimi nr . 1</b> Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë që plani i veprimit, rishikohet duke përcaktuar afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, duke u fokusuar në gjetjen e zgjidhjeve për mbledhjen e të hyrave në mënyrë të plotë dhe me kohë. Vendimi për revokim të licencave për operatorët që nuk kryejnë obligimet mund të jetë një formë që Komisioni duhet ta vlerësojë seriozisht.</p>	<p>KPM-ja ka ndërmarr veprimet e nevojshme dhe ka bërë ndryshimin e Rregullores për mënyrën e pagesës së taksës për licencë në fund të vitit 2014. Rregullorja e re e KPM-së për mënyrën e pagesës së taksës së licencës rregullon ato mangësi të gjetura në rregulloren e vjetër.</p>	<p>Janë marr masat për vitet në vijim.</p>	<p>Progres pozitiv</p>
2.	<p><b>Rekomandimi nr. 2</b> Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.</p>	<p>KPM nuk ka identifikuar dhe nuk ka hartuar ndonjë listë të rreziqeve. Arsyeja e mos menaxhimit të rreziqeve të mundshme është se Menaxhimi i rrezikut është në proces dhe sipas NJQH do të kemi trajnime të posaçme. Ne kemi pas një trajnim me zyrtarët e NJQH por nuk ka qenë i mjaftueshëm dhe se ende nuk ka filluar të zbatohet Menaxhimi i rrezikut. Në muajin dhjetor 2016 përsëri është mbajtur trajnimi dhe kemi pranuar formën standarde të menaxhimit të rrezikut dhe Pyetësozin e Vetë-vlerësimit.</p>	<p>Janë marr masat për vitet në vijim.</p>	<p>Progres pozitiv</p>

3.	<p><b>Rekomandimi nr. 3</b> Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë se Kryeshefi Ekzekutiv ka menaxhuar rreziqet në mënyrë efektive përmes delegimit të përgjegjësive tek nivelet tjera përkatëse dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë duke monitoruar se si rreziqet janë duke u menaxhuar.</p>	<p>KPM në trajnimin e radhës në dhjetor 2016 është informuar nga ana e NJQH se menaxhimi i rrezikut është në proces dhe do të vazhdojmë t'i përcjellim trajnimet e radhës në mënyrë që të kemi mundësi t'i identifikojmë rreziqet. Gjatë auditimit nga Auditorët e ZAP-it kemi shprehur pakënaqësitë rreth formulimit të paqartë të pyetësorit të Vetëvlerësimit dhe trajnimit të mbajtur nga ana e NJQH.</p>	<p>Janë marr masat për vitet në vijim.</p>	<p>Progres pozitiv</p>
4.	<p><b>Rekomandimi nr. 4</b> Në raste të blerjes nga mjetet e buxhetuara për kategoritë tjera, KPM duhet së pari të bëjë transferin e buxhetit nga një kategori në kategorinë tjetër buxhetore në përputhje me rregullat financiare të cilat lejojnë që deri në shumën prej 5% mund të bëhet nga ZKA pa aprovim paraprak nga Ministri i Financave.</p>	<p>KPM ka blerë një ( stabilizator) e cila nuk ishte paraparë në planin e prokurimit. Blerja ka qenë emergjente sepse mos forcimi i energjisë elektrike me stabilizator ka rrezikuar prishjen e të gjitha pajisjeve në sistemin e monitorimit. Në mungesë të buxhetit në kategorinë e kapitaleve, KPM është detyruar që blerjen ta kryejnë nga kategoria mallra dhe shërbime.</p>	<p>Janë marr masat që në të ardhmen në raste të tilla të bëhet transferi nga një kategori në tjetrën.</p>	<p>Progres pozitiv</p>
5.	<p><b>Rekomandimi nr. 5</b> Efektet e ndryshimit të rregullores nuk janë materializuar dhe si pasojë Kryetari i Komisionit duhet të gjejë mekanizma tjerë më efektiv siç mund të jetë revokimi i licencës për operatorët që nuk paguajnë me kohë obligimet.</p>	<p>Komisioni ka marrë vendim me 4 mars 2016 që ekzekutimi i kërkesave kreditore të bëhet përmes përmbaruesve dhe lidhur me zbatueshmërinë e këtij vendimi KPM do ta njoftojë ZAP.</p>	<p>Janë marr masat për vitet në vijim.</p>	<p>Progres pozitiv</p>
6.	<p><b>Rekomandimi nr. 6</b> Kryetari i Komisionit duhet të rishikojë me vendosmëri se janë marrë të gjitha masat në pajtim me rregulloren dhe ligjin për KPM-në, ndaj operatorëve të</p>	<p>Komisioni i Pavarur i Mediave në vazhdimësi ka pasur takime e komunikime me të licencuarit që kanë qenë në shkelje, gjithmonë duke qenë në pajtueshmëri me misionin e vet</p>	<p>Janë marr masat për vitet në vijim.</p>	<p>Progres pozitiv</p>

	cilët nuk i përmbushin obligimet. Në këtë aspekt duhet shqyrtuar mundësinë e revokimit të licencës.	si rregullator. Revokimin e një numri të konsiderueshëm të licencave KPM nuk e ka aplikuar për faktin që një masë e atillë do të kishte ndikim të drejtpërdrejt në të drejtën e publikut për t'u informuar dhe në lirinë e mediave dhe në lirinë e shprehjes.		
7.	<b>Rekomandimi nr. 1 - viti 2014</b> Kryetari i Komisionit duhet të monitoroj zbatimin e rregullores së re në praktikë për të siguruar respektimin e afatit të rishikuar, më 31 mars, për inkasimin e të hyrave. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime shtesë për mbledhjen e të hyrave të pa inkasuara të viteve paraprake.	KPM-ja ka ndërmarr veprimet e nevojshme dhe ka bërë ndryshimin e Rregullores për mënyrën e pagesës së taksës për licencë në fund të vitit 2014. Rregullorja e re e KPM-së për mënyrën e pagesës së taksës për licencën rregullon ato mangësi të gjetura në rregulloren e vjetër.	Janë marr masat për vitet në vijim.	Progres pozitiv
8.	<b>Rekomandimi nr. 5 – viti 2014</b> Kryetari i Komisionit duhet të rishikojë me vendosmëri se janë marrë të gjitha masat në pajtim me rregulloren dhe ligjin e KPM-së, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet. Në këtë aspekt duhet shqyrtuar mundësinë e revokimit të licencës dhe të konfiskimit të pajisjeve.	Për shkak të vonesave nga Gjykata Ekonomike e Kosovës, në lidhje me lëndët e proceduara nga Departamenti Ligjor gjatë viteve të kaluara, të arkëtueshmet janë grumbulluar dhe vlera e tyre është rritur ndër vite. Kjo ka qenë një arsye të rritjes së të arkëtushmeve.	KPM-ja ka ndërmarr hapat të ri sa i përket kësaj çështje ka fuqizuar mekanizmat e saj në lidhje me mos pagesën e taksës për licencë nga shërbimet audio-vizuale, duke nxjerr Rregulloren - KPM 2014/03 për mënyrën e pagesës së taksës për licencë.	Progres pozitiv

### *Rekomandime nga Raporti i Auditimit të ZAP-it*

### **Rekomandimi Nr. 1**

Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë që plani i veprimit, rishikohet duke përcaktuar afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, duke u fokusuar në gjetjen e zgjidhjeve për mbledhjen e të hyrave në mënyrë të plotë dhe me kohë. Vendimi për revokim të licencave për operatorët që nuk kryejnë obligimet mund të jetë një formë që Komisioni duhet ta vlerësojë seriozisht.

### **Rekomandimi Nr. 2**

Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

### **Rekomandimi Nr. 3**

Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë se Kryeshefi Ekzekutiv ka menaxhuar rreziqet në mënyrë efektive përmes delegimit të përgjegjësive tek nivelet tjera përkatëse dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë duke monitoruar se si rreziqet janë duke u menaxhuar.

### **Rekomandimi Nr. 4**

Në raste të blerjes nga mjetet e buxhetuara për kategoritë tjera, KPM duhet së pari të bëjë transferin e buxhetit nga një kategori në kategorinë tjetër buxhetore në përputhje me rregullat financiare të cilat lejojnë që deri në shumën prej 5% mund të bëhet nga ZKA pa aprovim paraprak nga Ministri i Financave.

### **Rekomandimi nr. 5**

Efektet e ndryshimit të rregullores nuk janë materializuar dhe si pasojë Kryetari i Komisionit duhet të gjejë mekanizma tjerë më efektiv siç mund të jetë revokimi i licencës për operatorët që nuk paguajnë me kohë obligimet.

### **Rekomandimi Nr. 6**

Kryetari i Komisionit duhet të rishikojë me vendosmëri se janë marrë të gjitha masat në pajtim me rregulloren dhe ligjin e KPM-së, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet. Në këtë aspekt duhet shqyrtuar mundësinë e revokimit të licencës.

### **Rekomandimi Nr. 1 - viti 2014**

Kryetari i Komisionit duhet të monitoroj zbatimin e rregullores së re në praktikë për të siguruar respektimin e afatit të rishikuar, më 31 mars, për inkasimin e të hyrave. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime shtesë për mbledhjen e të hyrave të pa inkasuara të viteve paraprake.

### **Rekomandimi Nr. 5 – viti 2014**

Kryetari i Komisionit duhet të rishikojë me vendosmëri se janë marrë të gjitha masat në pajtim me rregulloren dhe ligjin e KPM-së, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet. Në këtë aspekt duhet shqyrtuar mundësinë e revokimit të licencës dhe të konfiskimit të pajisjeve.

#